




Majlinda Hala Violeta Shamku Rreze Kryeziu Liburn Jupolli

Art muzikor 2






BOTIME

pegi



Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.botimepegi.al/>

Art muzikor 2



ISBN: 978-9951-843-37-9



9 789951 843379

Majlinda Hala Violeta Shamku Rreze Kryeziu Liburn Jupolli

ART MUZIKOR 9

Për klasën e 9-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
????????????
Redaktor letrar: Ergys PETIRTI
Korrektore letrare: Oriada DAJKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-37-9

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht
të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim,
përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht
ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

*Të gjitha tekstet letrare dhe jolettrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar
për qëllime didaktike.*

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

HYRJE

Të dashur nxënës,

Një nga udhëtimet më të bukura që mund të përjetoni gjatë shkollimit tuaj të arsimit të mesëm të ulët është ai me anë të muzikës, tingujve muzikorë. Ne si autorë jemi përkujdesur që gjatë këtij viti shkollor muzika që do t'ju shoqërojë, t'ju mundësojë njohjen nga afër jo vetëm të muzikës klasike, por edhe të zhanreve të tjera e sidomos edhe të vetë kulturës sonë tradicionale, e cila është shumë e pasur me këngë e valle. Ju do të keni mundësi të njihni ngjarje, rrethana, histori të popujve të ndryshëm me anë të këngëve që kemi zgjedhur për ju.

Ky libër, i cili kujdeset t'ju japë një kulturë të përgjithshme muzikore përshtatur nivelit tuaj shkollor, është i ndarë në tri pjesë kryesore. Në libër janë radhitur këngë për fëmijë, fragmente muzikore të shkëputura nga veprat më të rëndësishme të muzikës klasike, këngë dhe valle popullore e deri te këngët patriotike shqiptare, të cilat do t'ju shërbejnë edhe për të kremtuar manifestime të ndryshme.


Në libër janë radhitur disa karakteristika të teorisë muzikore (ndërtimit të muzikës), ushtrime me ritme të ndryshme, instrumente muzikore, pjesë e cila është mjaft e dëshirueshme nga ju.


Në libër jemi kujdesur t'ju njohim me kompozitorët, interpretuesit dhe krijuesit e muzikës klasike botërore e kombëtare, bazuar në stile të veçanta muzikore me të cilat do të keni mundësi të njoftoheni nga mësuesi juaj.

Me dëshirën e madhe që lëndën/nxënien ta bëjmë të lehtë, por edhe tërheqëse, ne kemi vendosur që numri më i madh i këngëve të ketë edhe shoqërimin me Qr code dhe kjo do të jetë mbështetje e madhe për ju gjatë interpretimit, por padyshim edhe për mësuesit/es tuaj, të cilët tashmë do ta kenë më të thjeshtë punën me pjesët dëgjimore.

Ne ju dëshirojmë udhëtim të bukur muzikor,

AUTORËT





PËRMBAJTJE

Rikujtojmë	8	
Njësia mësimore 1: Këngë arbëreshe.....	10	
Njësia mësimore 2: Tonaliteti në muzikë.....	12	
Njësia mësimore 3: Ushtrime këndimi.....	14	
Njësia mësimore 4: Luajmë në instrument.....	16	
Njësia mësimore 5: Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli.....	18	
Njësia mësimore 6: Muzika dhe shoqëria në Mesjetë.....	20	
Njësia mësimore 7: Krijim muzikor.....	22	
Njësia mësimore 8: Jeta kërkon dashuri.....	24	
Njësia mësimore 9: Kultura muzikore gjatë Rilindjes.....	26	
Verifiko njohuritë.....	28	
Njësia mësimore 10: Për ty Atdhe.....	32	
Njësia mësimore 11: Kultura muzikore gjatë Barokut.....	34	
Njësia mësimore 12: Përfaqësues dhe vepra muzikore.....	36	
Njësia mësimore 13: Kur bie fyelli e çiftelia.....	38	
Njësia mësimore 14: Luajmë në instrument.....	40	
Njësia mësimore 15: Kultura muzikore gjatë Klasicizmit.....	42	
Njësia mësimore 16: Përfaqësues dhe vepra muzikore.....	44	
Njësia mësimore 17: Intervista muzikore.....	46	
Njësia mësimore 18: Interpretues kosovarë.....	48	
Verifiko njohuritë.....	50	
Projekt 1: Muzika në periudhën baroke.....	52	



Njësia mësimore 19: Kultura muzikore gjatë Romantizmit.....56

Njësia mësimore 20: Përfaqësues dhe vepra muzikore.....58

Njësia mësimore 21: La donna è mobile.....60

Njësia mësimore 22: Krijues shqiptarë..... 62

Njësia mësimore 23: Muzika në shekullin XIX/XX.....64

Njësia mësimore 24: Përfaqësues dhe vepra.....66

Njësia mësimore 25: Luajmë në instrument.....68

Njësia mësimore 26: Njerëzit e agimeve.....70

Njësia mësimore 27: Muzika moderne, rryma dhe përfaqësues.....72

Njësia mësimore 28: The final countdown.....74

Verifiko njohuritë.....76

Projekt 2: Jeta dhe vepra e një kompozitori.....78

Njësia mësimore 29: Këngë moj.....82

Njësia mësimore 30: Krijim muzikor.....84

Njësia mësimore 31: Mall për mëmëdhenë.....86

Njësia mësimore 32: Interpretues shqiptarë.....88

Njësia mësimore 33: Mjetet teknike për regjistrim e dëgjim muzikor.....90

Njësia mësimore 34: Luajmë në kitarë.....92

Njësia mësimore 35: Luajmë në instrument.....94

Njësia mësimore 36: Profesione muzikore.....96

Verifiko njohuritë.....98

Projekt 3: Grupi ose këngëtari im i parapëlqyer.....100

Fjalor.....102

Referenca





Afresk muzike mesjetare (autor i panjohur)

Rikujtojmë

Njësia mësimore 1: Këngë arbëreshe

Njësia mësimore 2: Tonaliteti në muzikë

Njësia mësimore 3: Ushtrime këndimi

Njësia mësimore 4: Jeta kërkon dashuri

Njësia mësimore 5: Luajmë në instrument

Njësia mësimore 6: Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli

Njësia mësimore 7: Muzika dhe shoqëria dhe në mesjetë

Njësia mësimore 8: Krijim muzikor

Njësia mësimore 9: Kultura muzikore gjatë Rilindjes

Verifikojmë njohuritë



Aftësitë e nxënësit/es:

- **këndon** këngët në ritmet dhe tonalitetet e mësuara;
- **krijon** në ritmet e mësuara, duke përdorur simbolet muzikore përkatëse;
- **plotëson** më tej njohuritë mbi zhvillimin e muzikës, përfaqësuesit, veprat dhe krijimet përmes ngjarjeve kulturore;
- **dëgjon** muzikë dhe përjeton emocionet që përcjell ajo;
- **zbulon** ndjesitë që krijon muzika dhe i përshkruan ato;
- **reflekton** ndaj muzikës që dëgjon si pjesë e kohës në të cilën u krijua;
- **përdor** njohuritë për të krijuar ese, tema projektesh të ndryshme etj., individualisht ose në grup.



Fjalë kyçe:

tonalitet muzikor, Mesjetë, këndim gregorian, neumat, tetragram, monofoni, polifoni, organum.



Rikujtojmë

1 Rretho përgjigjen e saktë.

- **Dëgjo** "Himnin e Flamurit" dhe përcakto tonalitetin:
a. Do Maxhor; **b.** Sol Maxhor; **c.** Fa Maxhor.
- Në shkallën Sol+ dhe Fa+, gjysmëtonet ndodhen në gradët:
a. 2-3 dhe 5-6; **b.** 4-5 dhe 6-7; **c.** 3-4 dhe 7-8.

2 Rretho përgjigjen e saktë.

- Masa 5/8 formohet nga:
a. një masë e thjeshtë; **b.** dy masa të thjeshta; **c.** tri masa të thjeshta.
- Masa 7/8 ka:
a. 2 lëvizje dore; **b.** 3 lëvizje dore; **c.** 4 lëvizje dore.
- Masa 9/8 formohet nga:
a. dy masa të thjeshta; **b.** tri masa të thjeshta; **c.** katër masa të thjeshta.

3 Gjej emrin e shkallës muzikore.

- ▶ Shkalla maxhore me dy diezë është _____.
- ▶ Shkalla maxhore me dy bemolë është _____.

4 Rretho përgjigjen e saktë.

- Kënga polifonike këndohet në:
a) Shqipërinë e Veriut; **b)** Shqipërinë e Mesme; **c)** Shqipërinë e Jugut.

5 Plotëso fjalitë e mëposhtme.

- ▶ Simbolet kombëtare të një vendi janë:

6 Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme.

- ▶ Pjesë e folklorit tonë muzikor janë:

1. _____ 2. _____ 3. _____

- ▶ Këngët dhe vallet popullore ndahen në tri gjini:

1. _____ 2. _____ 3. _____

- ▶ Personat që merren me studimin e muzikës popullore, quhen:

_____.

- ▶ Instrumentet popullore i ndajmë në dy grupe:

1. _____ 2. _____

7 Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme.

- ▶ Opera e parë shqiptare quhet _____ dhe u kompozua nga kompozitori _____.

- ▶ Baleti i parë shqiptar është _____.

8 Shkruaj deri në tre tituj këngësh nga muzika shqiptare.

1. _____

2. _____

3. _____

9 Shkruaj deri në katër emra kompozitorësh kosovarë, që kanë kompozuar muzikë për filma.

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____





1 Këngë arbëreshe



Dëgjo këngën dhe diskuto

rreth arbëreshëve të Italisë dhe shqiptarëve në diasporë.
Ndaji informacionet që ke me shokët e shoqet e klasës.

- I -

Vajta kalova gjith' Kalabrinë
askund nuk gjeta si Arbërinë.
Vajta kalova gjith' Kalabrinë
askund nuk gjeta si Arbërinë.

- II -

Dy manushaqe në dorën time
ia zgjata njëren arb'reshës sime.
Dy manushaqe në dorën time
ia zgjata njëren arb'reshës sime.

- Refreni -

E lule-lu, e lule-lu,
e lule-lule macë-macë,
e un' për ty, e un' për ty,
e un' për ty 'o dalë pacë,
e dalë pac', e dal pac'
e dalë pac' është e vërtetë,
se zemra im', se zemra im',
se zemra ime je ti vetë.



Nini, S. (2021). *Një rrugëtim etnografik mbi veshjet e arbëreshëve të Italisë së Jugut*. Tiranë, QSPA.

Këngë arbëreshe

Moderato *Arbëreshe*



Vaj - ta ka - lo - va gjith' Ka - la - bri - në,
as - kund nuk gje - ta si Ar - bë - ri - në.
Dy ma - nu - sha - qe në do - rën ti - me,
ia zgja - ta një - rën arb' - re - shës si - me.
E lu - le - lu, e lu - le - lu, e lu - le -
lu - le, ma - cë, ma - cë.

A e dini se...

Pas vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, arbëreshët u shpërngulën dhe u vendosën në Itali për t'i shpëtuar pushtimit osman. Edhe pse të larguar që prej 600 vjetësh, ata ende i ruajnë traditat, gjuhën, veshjet, ritet dhe zakonet e tyre. Veç këngës "Vajta kalova", mjaft këngë të tjera arbëreshe mbeten të dashura për ne dhe këndohen edhe sot. Kënga "Moj e bukura More" është ndoshta kënga më e vjetër shqiptare, e cila këndohet edhe në ditët tona. Kjo këngë në njëfarë mënyre dëshmon jo vetëm mallin për atdheun, por edhe vetë krijimin e komunitetit arbëresh të Italisë. Për herë të parë, ajo dokumentohet në librin e arbëreshit Dhimitër Kamarda (1821-1882), më 1866. Autori i saj është i panjohur, por kënga vetë është ndër më të dashurat për të gjithë shqiptarët.





2 Tonaliteti në muzikë



Dëgjo dhe diskuto

fragment nga "Himni kosovar" dhe vër në dukje ndryshimin që ndodh përgjatë melodisë.



Për të shprehur një mendim muzikor, është i domosdoshëm bashkimi i disa tingujve në një sistem të përbashkët, të përcaktuar në lartësi dhe në marrëdhënie me njëri-tjetrin.

Tonalitet quhet lartësia e vendosjes së tingujve përgjatë një melodie.

Tonalitetet janë **maxhore** dhe **minore**, por ndryshojnë nga njëri-tjetri nga lartësia e tingujve. Numri i shenjave të shartimit, diez ose bemol, të vendosura pas çelësit, përcaktojnë tonalitetin e një pjese muzikore. Çdo tonalitet muzikor e merr emrin nga shkalla muzikore në të cilën ekzekutohet.

Ato i emërtojmë:

Do Maxhor ose C-Dur

Re Maxhor ose D-Dur

Sol Maxhor ose G-Dur

La minor ose a-mol

Re minor ose d-mol

Sol minor ose g-mol

Rikujto!

Shkallët maxhore **me diez**, i gjejmë duke u ngjitur 5 nota ose duke u ulur 4 nota nga tonika e shkallës paraardhëse.

Ndërsa shkallët maxhore **me bemol**, i gjejmë duke u ngjitur 4 nota ose duke u ulur 5 nota nga tonika e shkallës paraardhëse.

	DoM		Lam
SolM	Mim	FaM	Rem
ReM	Sim	SibM	Solm
LaM	Fa#m	MibM	Dom
Mim	Do#m	LabM	Fam
SiM	Sol#m	RebM	Sibm
Fa#M	Re#m	SolbM	Mibm
Do#M	La#m	DobM	Labm



Provo aftësitë muzikore

1 Përcakto tonalitetin maxhor ose minor pentagramet e mëposhtme.


a



masa e fundit

Andante

b



masa e fundit

Allegro

c



masa e fundit

Moderato

d



masa e fundit

e



masa e fundit



Portofoli yt

• **Krij**o një melodi prej 16 masash, duke zgjedhur ritmin dhe tonalitetin që dëshiron. Më pas, këndo krijimin tënd muzikor.





3 Ushtrime këndimi

Lexo dhe këndo

1

Moderato

"Mësuesit tim"

Muzika: N. Doko

O m'su - si im zem - ra më kën - don
se ti pa pu - shim di - je më dhu - ron
Ti gjith' buz - qesh - je ne na le - dha - ton
për t'ardh - men to - në me gjith' shpirt pu - non.

2

Allegretto

Popullore - Itali

3

Fragment nga opera "Fyelli magjik"

Moderato

Muzika: V. A. Moxart

O sa bu-kur, o sa ëm-bël kjo kën-gë tin - gë
Të kën - doj-më të vall - zoj-më se mu - zi - kën a - dhu-
Ilon, la la la la la la la la la la la la la. Mu - a
rojm' la la la la la la la la la la la la la. Me
ve - shi një kën-gë të till' më dë - gjon la la
kën-gë dhe va - lle të gjith' të gë-zojm' la la
la la la la la la la la la la la la la. la la la
la la la la la la la la la la la la la.



Portofoli yt


● **Krij**o një melodi prej 16 masash, duke zgjedhur ritmin dhe tonalitetin që dëshiron. Më pas, këndoje krijimin tënd muzikor.






4 Luajmë në instrument


Luaj me bllokflaut



1

Popullore





2

Moderato

Popullore - Arbëreshe





5 Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli



Dëgjo dhe diskuto

fragmentin muzikor të shkëputur nga "Te Deum laudamus" kompozuar nga Niketë Dardani dhe përcakto sa zëra dëgjon të këndojnë.



Zhvillimi i muzikës shqiptare, krahasuar me vende të tjera evropiane, ka pësuar një zhvillim jolinear të saj. Studiuesit kanë bërë çështje e mundur për ndriçimin e rrugës së zhvillimit muzikor të përshkruar, duke nxitur kështu që të flasë "koha memece" e kësaj muzike.

Niketa i Remesianës (340-414), me origjinë nga Dardania (Kosova e sotme), ishte kompozitor, prift e ipeshkv katolik. Njihet edhe si muzikanti i parë shqiptar me emrin Niketa i Ramezianës (sot qyteti Bela Palanka në Serbinë juglindore). Ishte teolog dhe muzikant i njohur i kohës. Vepra e tij më e njohur është himni "Te Deum laudamus" ("Ty, o Zot, të lëvdojmë"), i përhapur në Evropë më 525 dhe mbi të cilin kanë krijuar muzikë kompozitorë të tillë si Luli, Bah, Hendel etj.

Në fillim të shekullit të kaluar, britaniku A. E. Burn botoi në Kembrixh (1905) monografinë "Niceta of Remessiana", ku përmend thënien e vetë Niketës "Dardanus sum" (lat. dardan jam).

Niketë Dardani është cilësuar nga etnomuzikologjia shqiptare si personalitet poliedrik, teolog e muzikant. Ka qenë autor i një varg këngësh e himnesh të shkruara në latinisht. Për meritat e tij, Kisha Katolike e ka shpallur shenjtor dhe festa e emrit të tij është 22 qershori.



Përfaqësuesi më i madh i kohërave të mesjetës është kompozitori **Jan Kukuzeli**, nga një familje durrsake. Supozohet të ketë jetuar në shek. XII. Për një kohë të gjatë, ai mbante postin e udhëheqësit të korit të Kishës së Madhe të Krishtit, Shën Sofisë, në Kostandinopojë (tani xhamia e njohur Aja Sofia në Stambollin e sotëm). Kukuzeli e braktisi papritmas pallatin perandorak në Kostandinopojë dhe zbriti nga një anije në malin e shenjtë në Atos të Greqisë. Më vonë, shërbeu edhe në disa manastire të tjera në Mal të Zi, Durrës e gjetiu dhe veprimtaria e tij krijuese kryesisht lidhet me muzikën kishtare (a capela/pa përcjellje instrumentale).

Si kompozitor, Jan Kukuzeli dallohej për kompozimin e shumë himneve dhe i një libri të këndimit, i cili titullohet Polielei i Burgvigës. Ishte teoricien i shkëlqyer muzike, duke kryer dy reforma të mëdha. Shpiku një sistem të ri të shkrimit muzikor, i cili u quajt sistemi kukuzelian, duke reformuar sistemin e vjetër bizantin të shkrimit muzikor. Gjithashtu, atij i njihet edhe merita e futjes së polifonisë në sistemin e këndimit kishtar.



Afresk i shek.XVIII, vepër e ikonografëve Konstandin e Athanas Zografi. Kisha qendrore e Manastirit të së Tërëshenjtës Mari, Ardenicë (Lushnjë).

Jan Kukuzeli, Psalm ➔



Portofoli yt

- Kërkoni nga burime të ndryshme informacioni (media, biblioteka, interneti) kuriozitete lidhur me jetën dhe krijimtarinë e dy muzikantëve shqiptarë.



6 Muzika dhe shoqëria në Mesjetë



Dëgjo dhe diskuto

fragmentin muzikor të shkëputur nga "Deum verum" dhe përcakto sa zëra dëgjon të këndojnë.



Me termin **Mesjetë** identifikohet ajo periudhë e historisë evropiane, që fillon nga rënia e Perandorisë Romake (476 e.r.) dhe përfundon me zbulimin e Amerikës (1492). Gjatë kësaj periudhe, muzika, ashtu si letërsia, arkitektura dhe piktura qenë nën ndikimin e madh të kishës katolike. Muzika bazohej kryesisht në meloditë e vjetra të krishtera si *psalmet*, *himnet* etj.

Kënga gregoriane ose **korali gregorian** e mori emrin nga Papa Gregori i Madh (Gregorius I Magnus), i cili e drejtoi Kishën Katolike nga viti 590 e.r. deri në 604 e.r. Këto këngë ishin për *kore burrash* dhe këndoheshin njëzëri nga i gjithë kori, prandaj quheshin edhe monofonike. Ato kishin *melodi solemne* dhe *strukturë të thjeshtë* dhe nuk shoqëroheshin nga instrumente muzikore. Tekstet e tyre shkruheshin në latinisht, që ishte gjuha zyrtare e kishës. Këngët gregoriane patën rëndësi të veçantë në historinë e muzikës, pasi u shkruan me disa simbole që quheshin neuma (nga greqishtja e vjetër: *shenja*).

Neumat përdoreshin vetëm në krijimin e melodive me një zë, por me zhvillimin e muzikës *shumëzërëshe*, *deshifrimi* i tyre u bë i pamundur. Në fillim të shek. XI, teoricieni i muzikës Guido D'Areco (Guido D'Arezzo) përdori një metodë të thjeshtë për të mbajtur mend meloditë, duke krijuar një sistem të ri praktik për shkrimin e notave. Ai vendosi shenjat *mbi* dhe *ndërmjet* katër vijave paralele horizontale që u quajtën *tetragram*, duke u dhënë atyre një kuptim të saktë.



Nga libri "4-aspetti di vita quotidiana, canto in chiesa" i Tacuina Sanitatis (shek. XIV). Autori i pikturës, i panjohur.

A e dini se...

Nga himni latin për Shën Gjonin, "**Ut queant laxis**", Guido D'Areco mori rrokjen e parë të çdo vargu dhe me to emërtoi çdonjërin nga notat. Emërtimi i tyre ishte **UT, RE, MI, FA, SOL, LA**.

UT u zëvendësua më pas me **DO** nga muzikologu Xhovani Batista Doni (Giovanni Battista Doni). Nota **SI** iu shtua më vonë sistemit të notave. Ajo u formua nga inicialet e *Sancte Iohannes* (latinisht: Shën Gjoni).

Vargjet latinisht të himnit të Shën Gjonit, prej të cilave u morën rrokjet për emërtimin e notave.

Monofoni quhet një melodi, që këndohet ose luhet në unison, pra ka një vijë melodike. Termi **polifoni** vjen nga greqishtja e lashtë dhe do të thotë këndim me shumë zëra.

Stilet muzikore që u zhvilluan gjatë Mesjetës qenë *stili monofonik* dhe *stili polifonik*. **Polifonia** u zhvillua si një vazhdim i këngëve gregoriane, të cilat në mënyrë spontane filluan të këndoheshin me shumë zëra. Sistemi muzikor kaloi nga sistemi *neuma* në atë të quajtur *tetragram*, ku shenjat e notave kishin formë katrore. Në këtë mënyrë lindi forma e parë polifonike që u quajt **organum**, e cila në fillim këndohej me 1 dhe 2 zëra, ndërsa më pas me 3 dhe 4 zëra.

Gjatë kësaj periudhe, **instrumentet muzikore** përdorehin vetëm për shoqërimin e muzikës laike. Ndër to përmendim: *liutin* (lloj violine), *kitarën* (instrument me tela) dhe *viellën* (instrument me hark), si dhe *trombën* e *kornon*, që përdorehin gjatë ndeshjeve sportive. Muzika kishtare nuk shoqërohej me instrumente.

Hildegard von Bingen, një murgeshë gjermane, personalitet i arteve dhe i shkencave në shekullin XII, u bë ndër emrat **përfaqësues** në kompozimin e këngëve gregoriane. Vepra e saj më e njohur është *Mjeshtëria e Ordos*, e cila përfshin 82 pjesë muzikore.

Kompozitorë të tjerë të shekullit XII janë Leonini (Léonin) dhe Perotini (Pérotin), që kompozuan pjesët e para polifonike.



"Mbreti David dhe muzikantët me psalter, tuba, organo, timpan dhe harpë", miniaturë prej një dorëshkrimi të shek. XIII



Viella, foto e shkëputur nga dorëshkrimi i shekullit të 14-të nga Boethius, *De Arithmetica*. Napoli, Biblioteca Kombëtare, MS V.A.14, fol. 47r.



Korno



Viella, foto e shkëputur nga i dorëshkrimi "Davidi dhe Muzikantët" nga Psalteri anglez (shekulli i 12-të). Glasgow, Biblioteca Universitare.



Portofoli yt

- Kërkoni nga burime të ndryshme informacioni (media, biblioteka, interneti) kuriozitete lidhur me instrumentet muzikore gjatë periudhës së mesjetës.



Krijim muzikor



Dëgjo dhe diskuto

krijimin tënd muzikor dhe të shokëve.

Melodia, që të quhet e tillë, duhet të plotësojë disa kritere. Ndaj, nëse duam të krijojmë një melodi, duhet të mbajmë parasysh disa kritere. Krijimi muzikor duhet:

- të ketë tonalitetin muzikor, i cili zhvillohet nëpërmjet një prej shkallëve muzikore;
- të zhvillohet duke zgjedhur ritmin muzikor, i cili mund të jetë 2/4, 3/4, 4/4 etj.;
- të pasurohet edhe me elemente muzikore të ndryshme të gjuhës muzikore;
- të shoqërohet vija melodike me tekstin poetik të parapëlqyer.



A e dini se...

Dy elementet thelbësore të gjuhës së muzikës janë **melodia** dhe **ritmi**. Asnjë muzikant nuk do të mund të bënte pa këto elemente. Ky fakt vlen për gjithë krijimtarinë vokale dhe instrumentale. Ka popuj për të cilët ritmi zë vendin e parë, kuptohet, nëpërmjet instrumenteve më të preferuara që kanë. Kështu, te populli afrikan spikat përdorimi i instrumenteve të perkusionit, i cili bazohen kryesisht te ritmi. Në Afrikë, vendin kryesor mes instrumenteve e zë tamburi. Ekzistojnë tipa të shumëllojshme tamburesh, të cilat ndryshojnë nga forma dhe nga tingulli. Ka tambure për çdo stinë të vitit, tambure për raste festash fetare, për ceremoni mortore etj. Disa lloje tamburesh prodhohen posaçërisht për t'u luajtur vetëm, por ka edhe tambure të destinuara për orkestër. Këto orkestra, shumë të pasura me tinguj perkusivë, na shtojnë të kuptojmë se ka edhe një gjuhë muzikore, e cila mund të krijojë atë që quhet "MELODI".




Dafina Zeqiri Nushi


Dafina Zeqiri Nushi (1984) është kompozitore e muzikës orkestrale dhe muzikës korale, që ka performuar në shumë vende të Evropës, si dhe në SHBA. Ka studiuar në Shkollën e Mesme të Muzikës "Prenk Jakova", më pas në Universitetin e Prishtinës (për kompozim) dhe më tej në Universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Për herë të parë, bëri emër në Konkursin e kompozitorëve të Rinj Çesk Zadeja (2002). Prej këtu, mori pjesë suksesshëm në shumë konkurse të tjera në Ballkan, Evropë dhe SHBA. Ndër veprat e saj të shënuara, veçohen: Atmosferë për flaut dhe piano, Përreth për ansambël dhome, Variacione për orkestër, Ëndrra për violinë, Telegoni për kuartet me harqe, Memento për violinë dhe orkestër; Muzikë Funerale për piano; Koncert për piano dhe orkestër.

Duke u mbështetur në njohuritë muzikore që ke marrë, fillo të krijosh një melodi sipas rregullave të mëposhtme.

- Përcakto tonalitetin muzikor.
- Përcakto ritmin muzikor 2/4, 3/4 ose 4/4.
- Përdor kombinime të gjatësive të ndryshme ritmike.
- Plotëso krijimin tënd muzikor me një tekst poetik të zgjedhur.
- Prezanto krijimin tënd muzikor, duke e kënduar atë.



teksti poetik



- A mund të themi tani se ti di të kompozosh një melodi muzikore?



Portofoli yt

• **Diskuto** krijimin tënd dhe krijimin e shokut, si dhe jep gjykimin për krijimin muzikor duke folur për:

- a) ritmin që ka zgjedhur dhe vlerat e notave dhe pushimeve që përdoren gjatë krijimit;
- b) tonalitetin e përdorur në krijim;
- c) emocionin që përcjell krijimi muzikor.



8 Jeta kërkon dashuri



Dëgjo dhe diskuto

me shokët/shoqet e klasës thënie: "Sa më shumë e mendoj, aq më shumë e kuptoj që s'ka asgjë më artistike sesa të duash të tjerët".

(Vincent van Gog)

- I -

Se jeta ikën e jo nuk kthen,
dita pret diellin që sapo vjen,
ma jep ti dorën, të lutem, pak,
un' ta jap zemrën në çast.

- II -

Zemrat kërkojnë veç dashuri,
jo lot në sy; nënat kërkojnë
nga çdo njeri, nga çdo njeri
jeta kërkon dashuri.

- Refreni -

Kjo dashuri që sundon në k'të bot'
duam të zgjohet te çdo njeri,
duam që zemrat të ken' lumturi
ashtu si un', ashtu dhe ti.
Hej, hej, jeta kërkon dashuri.



Grup muzikor fëmijësh (foto: Dreamstime)

Jeta kërkon dashuri

Allegretto

Muzika: Edmond Zhulali

Teksti: Agim Doçi

Se je - ta i - kën e jo nuk kthen,
di - ta pret die - llin që sa - po vjen,
ma jep ti do - rën të lu - tem pak,
un' ta jap zem - rën në çast. Zem - rat kër - kojn'
veç da - shu - ri, jo lot në sy
në - nat kër - kojnë, nga çdo nje - ri, nga çdo nje - ri
je - ta kër - kon da - shu - ri.
Kjo da - shu - ri që sun - don në k'të bot' du - am të zgjo - het
tek çdo nje - ri, du - am që zem - rat të ken' lum - tu - ri,
ash - tu si un', ash - tu dhe ti. Hej, hej,
je - ta kër - kon da - shu - ri.



Portofoli yt

- **Diskuto** me shokët për marrëdhëniet si: shoqëria, dashuria, mirënjohja, virtytet që karakterizojnë secilin prej nesh në jetë.



9 Kultura muzikore gjatë Rilindjes



Dëgjo dhe diskuto

fragmentin muzikor të shkëputur nga “Ave Maria Stella” të Gijom Dyfej (Guillaume Dufay) dhe përshkruaj shkurtimisht çfarë po dëgjon.



Periudha e Rilindjes daton rreth shek. XV-XVI, periudhë kur pati arritje të rëndësishme në shumë fusha: art, letërsi, muzikë, ekonomi, ndërsa zbulimet e mëdha gjeografike dhe ekonomike e çuan Evropën Perëndimore drejt ndryshimeve të mëdha shoqërore, historike, kulturore e artistike. Emra mjaft të njohur të artit ishin Mikelanxhelo (*Michelangelo*), Rafaelo Sancia (*Raffaello Sanzia*), Dante Aligeri (*Dante Alighieri*) dhe Petrarka (*Francesco Petrarca*). Krahas arritjeve në art e letërsi, edhe shkenca iu kundërvu parimeve fetare, që deri në atë kohë ishin respektuar rreptësisht nga të gjithë. Galileo Galilei, Nikola Koperniku (*Nicolaus Copernicus*) dhe Kristofor Kolombi (*Cristoforo Colombo*) dolën hapur kundër kishës, me teoritë dhe zbulimet e tyre.

Gjatë kësaj kohe, muzika njohu zhvillime të rëndësishme: u përcaktuan tipare të reja të saj, u krijua një stil i ri, ku harmonia e plotë e akordeve dhe teksti ishin një nga parimet kryesore të kompozitorëve të kohës. U zhvillua *muzika popullore* dhe *muzika instrumentale*, u zhvillua më tej polifonia, duke u krijuar shkollat polifonike.

Veprat muzikore u mbështetën kryesisht në ritmet e muzikës popullore, prej së cilës morën formë lloje të tjera muzikore si: *balada*, *madrigali* dhe *kaça*.

Kaça është formë muzikore me dy zëra, këngë e shpejtë, teksti i së cilës trajton një skenë gjahu.

Balada është formë muzikore më e thjeshtë nga përmbajtja, që këndohet nga një solist, me kor ose shoqërim instrumental.

Madrigali është formë muzikore polifonike me dy ose tre zëra, që zakonisht përbëhet nga dy strofa dhe një refren, me subjekt mitologjik ose humoristik. Në shekullin XVI, madrigali këndohej me 3-4 deri në 6 zëra. Kjo formë muzikore tërhoqi vëmendjen e shumë kompozitorëve të Rilindjes, si: Xhovani Pierluixhi Palestrina (*Giovanni Pierluigi da Palestrina*), Xhovani Gabrieli (*Giovanni Gabrieli*), Orland de-Lasy (*Orlande de Lassus*), Monteverdi (*Claudio Monteverdi*).

Shkolla polifonike u ndikua shumë nga **shkolla flamande** ku bënë pjesë Franca, Holanda dhe Belgjika.

Kompozitorët më të famshëm të saj janë: Gijom Dyfej, Johanes Okehem (*Johannes Ockeghem*) (kompozitor i pjesës muzikore për 36 zëra), Zhoskin de-Pre dhe Orland de-Lasy (një nga kompozitorët më të njohur të kohës).

Të tjera shkolla muzikore që dhanë një kontribut me vlerë në zhvillimin e mëtejshëm të polifonisë gjatë shekullit XIV, ishin shkolla veneciane dhe shkolla e Romës.



Gijom Dyfej dhe Zhil Bënshua (Gilles Binchois)

Shkolla veneciane zhvilloi dhe përpunoi më tej metodat dhe shkrimin muzikor. Përfaqësuesit kryesorë ishin Andrea Gabrieli dhe nipi i tij Xhovani Gabrieli (*Giovanni Gabrieli*), të cilët u dhanë krijimeve të tyre muzikore një tingëllim të ri. Në krijimet e tyre, përveç organos, ata përfshinë edhe instrumente të tjera, si: violinën, flautin, trombonin etj.



Shkolla Veneziane

Shkolla romane u përfaqësua nga Xhovani Pierluixhi Palestrina (1525-1594). Ai punoi shumë për korin *a cappella* (këndim pa shoqërim instrumental). Veprat e tij muzikore dëshmojnë për zhvillimin dhe arritjet e muzikës gjatë periudhës së Rilindjes.

Instrumentet muzikore, që u përdorën gjatë kësaj periudhe ishin *organo e klaviçembali, liuti, viola e tromba*, kurse instrumenti i *violinës* filloi të shfaqej më vonë, në gjysmën e dytë të shekullit XVI. Gjatë kësaj kohe, kompozitorët filluan të krijojnë pjesë solo për instrumente të ndryshme, duke vijuar më pas me pjesë instrumentale. Fundi i shekullit XVI, shënoi krijimin e melodramës (operës).

Xhovani Pierluigi Palestrina (1525 - 1594) ishte anëtar i korit të fëmijëve, më vonë organist, mësues dhe drejtues i korit të kishës së Shën Pjetrit në Romë, Itali. Ky kompozitor i përket periudhës së Rilindjes dhe e gjithë krijimtaria e tij i kushtohet besimit fetar. Palaestrina ka krijuar shumë vepra muzikore si: motete, himne, madrigal dhe rreth 105 mesha ndër të cilat më e njohur është “Mesha e Papa Marçelit”. Kompozimet e tij janë vokale me polifoni të pastër e të thjeshtë, por mjaft të pasura dhe të lavdidshme.



Xhovani Pierluixhi Palestrina


Xhovani Palestrina, "Mesha e Papa Marçelit" ➔



Provo aftësitë muzikore

1. Plotëso saktë përkufizimet.

- ▶ Termi Rilindje _____
- ▶ Balada është formë muzikore që _____
- ▶ Kaça është formë muzikore që _____
- ▶ Madrigali është formë muzikore që _____
- ▶ Instrumentet muzikore të kësaj periudhe ishin _____



Verifiko njohuritë

1

Rretho përgjigjen e saktë.

► Tonalitetet maxhore dhe minore ndryshojnë nga:

- a) intensiteti i tingujve;
- b) gjatësia e tingujve;
- c) lartësia e tingujve.

2

Përcakto nëse pohimet e mëposhtme janë të sakta apo të gabuara.

- a) Shkrimi i notave u krijua në Mesjetë nga Guido D'Areco (Guido D'Arezzo). V G
- b) Polifonia në Mesjetë këndohej me një zë. V G
- c) Instrumentet më të përdorura në Mesjetë ishin kitara, liuti, tromba. V G
- d) Gjatë kësaj periudhe, instrumentet muzikore përdoreshin vetëm për shoqërimin e muzikës kishtare. V G

3

Përcakto një nga karakteristikat e shkollave muzikore që lulëzuan gjatë periudhës së Rilindjes.

Shkolla veneciane _____

Shkolla romane _____

Shkolla flamande _____

4

Plotëso fjalitë e mëposhtme.

- a) Këngët gregoriane këndoheshin vetëm nga _____.
- b) Muzikanti që krijoi sistemin e parë muzikor të notave ishte _____.
- c) Zhvillimi i muzikës në periudhën e Mesjetës i takon shekujve _____.
- d) Këngët gregoriane u quajtën kështu, sepse _____
- e) Rrokjet e "Himnit të Shën Gjorit", prej të cilave morën emrin notat muzikore, janë:

- f) Kompozitori që shkroi për organo ishte _____. Ai e pasuroi literaturën organiste
me _____.

5

Krijo një ushtrim me 16 masa muzikore, në ritmin 3/4 dhe tonalitetin **Re Maxhor**.





Njësia mësimore 10: Për ty Atdhe

Njësia mësimore 11: Kultura muzikore gjatë Barokut

Njësia mësimore 12: Përfaqësues dhe vepra muzikore

Njësia mësimore 13: Kur bie fyelli e çiftelia

Njësia mësimore 14: Luajmë në instrument

Njësia mësimore 15: Kultura muzikore në klasicizëm

Njësia mësimore 16: Përfaqësues dhe vepra muzikore

Njësia mësimore 17: Intervista muzikore

Njësia mësimore 18: Interpretues kosovarë

Verifiko njohuritë

Projekt 1: Muzika në periudhën



Aftësitë e nxënësit/es:

- **këndon** këngët në ritmet dhe tonalitetet e mësuara;
- **krijon** në ritmet e mësuara, duke përdorur simbolet muzikore përkatëse;
- **plotëson** më tej njohuritë mbi zhvillimin e muzikës klasike, përfaqësuesit, veprat dhe krijimet përmes ngjarjeve kulturore;
- **dëgjon** muzikë dhe përjeton emocionet që përcjell ajo;
- **zbulon** ndjesitë që krijon muzika dhe i përshkruan ato;
- **reflekton** ndaj muzikës që dëgjon, si pjesë e kohës në të cilën u krijua;
- **përdor** njohuritë për të krijuar ese, tema projektesh të ndryshme etj., individualisht ose në grup.



Fjalë kyçe:

barok, koncert, melodramë, oratorio, balet, iluminizëm, klasicizëm, opera bufa, opera seria, muzikë me program, sonatë.



10 Për ty Atdhe



Dëgjo këngën dhe diskuto

duke cituar deri në dy metafora të përdorura në tekstin e këngës.

- I -

Për ty atdhe,
ma të bukrën kang',
me fuqin' e k'saj zemre,
do t'këndoj,
për k'to male,
për k'to fusha të gjana,
për kët' vend,
ku sot i lumtur jetoj.

- II -

I bukur je,
ngrihesh madhështor,
si një kështjell' e pamposhtur,
ti qëndron.
Në mes dallgësh,
shkëmb graniti vigan,
s'u përkule,
nga çdo stuhi e tufan.



Gryka e Rugovës



Prishtina në mbrëmje



Bregu i Dhërmiut

Për ty Atdhe

Andante

Teksti dhe muzika: Pjetër Gaci

Për ty at - dhe, më të buk - rën kang',
 me fuq - in' e k'saj zem - re do t'kën - doj, për k'to
 ma - le, për k'to fu - sha të gja - na, për k'të vend ku
 sot i lum - tur je - toj. për k'to
 I bu - kur je ngri - hesh ma - dhë - shtor,
 si kësh - tjell' e pam - po - shtur ti qën - dron. Në mes
 dall - gësh, shkëmb gra - ni - ti vi - gan, s'u për -
 D.C. al Fine
 ku - le nga çdo stu - hi e tu - fan.



11 Kultura muzikore gjatë Barokut



Dëgjo dhe diskuto

fragmente muzikore të shkëputura nga *Concerto Grosso* “Katër stinët” e Vivaldit, duke përshkruar emocionet dhe ndjesitë që të krijon muzika.



Termi **barok** vjen nga portugalishtja (*barroco* – perlë me formë të çrregullt) dhe u përdor për herë të parë në vitin 1734. Stili barok u pasqyrua në arkitekturë, letërsi, pikturë dhe në muzikë. Në atë kohë, fisnikët organizonin në oborret e tyre veprimtari të vazhdueshme muzikore. Periudha baroke në muzikë daton mes viteve **1600-1750**, periudhë e cila u karakterizua nga një larmi stilesh muzikore. Faktorë ndikues të këtij zhvillimi ishin: trashëgimi i instrumenteve (*liuti, viola, organo, klaviçembali* etj.), përsosja e instrumenteve (*violina, violonçeli* etj.), si dhe ndërtimi i instrumenteve të reja (*fagoti, klarineta*). Organoja baroke u bë simbol i muzikës instrumentale të shekullit XVII, ndërsa instrumenti i violinës u përsos më tej nga mjeshtri i madh *Antonio Stradivari*. Kjo çoi në formimin e orkestrave të para, të cilat filluan të krijojnë një lidhje më të alternuar të instrumenteve.



Edgar Bundy (Edgar Bundy), “Antonio Stradivari”

të harqeve dha kompozitori Arkanxhelo Koreli (Arcangelo Corelli) (1653-1713). Roli i muzikës instrumentale nuk ishte të shoqëronte këndimin, por fillon të paraqitet si një formë e pavarur e muzikës, solistike, muzikë dhome dhe orkestrale. Kjo erdhi edhe për shkak të përsosja e instrumenteve muzikore si instrumentet me hark, organoja, klaviçembali, piano etj.

Karakteristikë e muzikës baroke është se ajo ishte dinamike, e lëvizshme dhe ndonjëherë tragjike.

Karakteristikë e muzikës baroke ishte ritmi i përsëritur, meloditë të pasura dhe me zbukurime, ngjyrimi dinamik, gjuha shprehëse. Gjinitë e reja muzikore ishin: minueti, trio-sonata (muzikë dhome), sonata solo, koncerti etj.

Muzika vokale filloi të zhvillohej përmes dramave muzikore. Termi melodramë vjen nga greqishtja e lashtë (*melos* – këngë dhe *dramma* – veprim) dhe nënkupton një formë spektakli, ku rrëfëhet një histori me anë të muzikës dhe të të kënduarit. Nëpërmjet fjalës, kënga përcillte ndjenjat dhe emocionet, ndërsa *muzika*, dramatizmin e veprës.

Gjatë kësaj periudhe u zhvillua **muzika instrumentale**.

Një kontribut të madh për zhvillimin e kompleksit të harqeve dha kompozitori Arkanxhelo Koreli (Arcangelo Corelli) (1653-1713). Roli i muzikës instrumentale nuk ishte të shoqëronte këndimin, por fillon të paraqitet si një formë e pavarur e muzikës, solistike, muzikë dhome dhe orkestrale. Kjo erdhi edhe për shkak të përsosja e instrumenteve muzikore si instrumentet me hark, organoja, klaviçembali, piano etj.



Organo e periudhës baroke

Melodrama lindi në Itali (fundi i shek. XVI), në qytetin e Firences, dhe u përhap edhe në vende të tjera (Francë, Gjermani, Angli). Melodrama u zëvendësua me operën, e cila është gjini e artit skenik, që përfshin disa lloje artesh: dramën, muzikën, skenografinë etj.

Oktavio Rinuçini (*Ottavio Rinuccini*), ishte i pari që hodhi idenë e operës duke shkruar tekstin me titull “Dafne”, ndërsa kompozitori Jakopo Peri (*Jacopo Peri*) krijoi muzikën e saj.

Në vitin 1594, lindi opera e parë e titulluar gjithashtu “Dafne”, dorëshkrimi i së cilës humbi. Më pas, u krijua opera “Euridice”, e cila është e dokumentuar. Ajo u kompozua nga Jakopo Peri dhe Xhulio Romolo Kaçini (*Giulio Romolo Caccini*), me subjekt të bazuar në legjendën e Orfeut, i cili në mitologjinë greke simbolizon forcën magjepsëse të këngës.

Oratorio është formë muzikore dramatike, me tekst në gjuhën latine, e ngjashme me operën, e cila dëgjohej kryesisht në kishë. Ndryshe nga opera, oratorio bazohej në një subjekt kishtar dhe nuk shfaqte nevojën e skenografisë dhe kostumeve. Luhej nga dy ose më shumë këngëtarë, që këndonin në një zë dhe shoqëroheshin nga kori.



Foto nga opera “Euridice”

Baleti vjen nga italishtja “balletto”, që do të thotë “valle” dhe është një shfaqje skenike ku veprimi dramatik kryhet përmes lëvizjes, vallëzimit dhe pantomimës nën shoqërimin e muzikës. Format e para të baletit i gjejmë në ritualet primitive, në ceremonitë, në tragjeditë dhe komeditë greke, në lojërat e këngëtarëve të rrugës dhe të zbavitësve të Mesjetës. Si formë teatrale e lojës, baleti filloi të zhvillohej në Evropën Perëndimore në periudhën e Rilindjes, në vitet 1300-1600. Shkollat e para të baletit u hapën më 1661, periudhë që shënon fillimet e baletit klasik, i cili dallohet për lëvizje të qarta, pantomimë dhe ndjenjë.




Provo aftësitë muzikore

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme.

- Periudha baroke u zhvillua gjatë viteve _____. Instrumentet muzikore që u përsosën gjatë periudhës baroke, janë: _____.
- Format muzikore vokale që u zhvilluan gjatë periudhës baroke, janë: _____.
- Format muzikore instrumentale që u zhvilluan gjatë periudhës baroke, janë: _____.
- Opera e parë e dokumentuar titullohet: _____.



12 Përfaqësues dhe vepra muzikore



Klaudio Monteverdi

Klaudio Monteverdi (*Claudio Monteverdi*) (1567-1643) është kompozitor i periudhës baroke, që kompozoi në gjininë e operës. Opera e tij e parë, "Orfeu", u shfaq në vitin 1607, ndërsa një vit më pas u shfaq opera tjetër e tij "Ariana", vepër e cila e përcaktoi Klaudio Monteverdin si një nga reformatoret dhe përfaqësuesit më të njohur të operës.



Klaudio Monteverdi "Ariana" ➞

Aleksandër Skarlati (*Alessandro Scarlatti*) (1659-1725) ndihmoi në zhvillimin e mëtejshëm të operës. Ai përcaktoi qartë formën e *aries*, *recitativit*, *uverturës*, dhe ruajti raportet e muzikës me dramën. Skarlati është një nga themeluesit e shkollës operistike napoletane dhe krijues i shumë operave, që shquhen kryesisht për rrjedhshmërinë dhe ekspresivitetin e tyre. Përveç oratoriove dhe serenatave, të cilat shfaqin një stil të ngjashëm, krijimtaria e tij përbëhet edhe nga 500 kantata solo, të kompozuar për muzikën e dhomës.



Aleksandër Skarlati



Xhovanni Pierluigi Palestrina

Xhovanni Pierluigi Palestrina (1525-1594) ishte anëtar i korit të fëmijëve, më vonë organist, mësues dhe drejtues i korit të kishës së Shën Pjetrit në Romë, Itali. Ky kompozitor i përket periudhës së Rilindjes dhe e gjithë krijimtaria e tij i kushtohet besimit fetar. Palaestrina ka krijuar shumë vepra muzikore si: motete, himne, madrigal dhe rreth 105 mesha ndër të cilat më e njohur është "Mesha e Papa Marçelit".

Kompozimet e tij janë vokale me polifoni të pastër e të thjeshtë, por mjaft të pasura dhe të lavdardhshme.



Xh. P. Palestrina, "Mesha e Papa Marçelit" ➞



Georg Fridrh Hendel

Georg Fridrih Hendel (*Georg Friedrich Händel*, 1685-1759) lindi në Halle të Gjermanisë, më 1685. Prirja e tij për muzikë u duk që në moshë të vogël. Më pas, ai punoi si organist në kishën e qytetit të tij dhe si mësues i Kolegjit të Reformatoreve, ku edhe kompozoi pjesët e para muzikore që ishin kantata dhe korale. Në vitet 1707-1710, shkoi në Itali, ku kompozoi rreth 40 opera, me të cilat solli një përmbajtje të re, larg skematizmit të operave italiane. Ai punoi shumë për oratorion derisa e kristalizoi formën e saj, duke i dhënë një zhvillim dramatik dhe duke pasqyruar ngjarje të kohës. Kori zë një vend mjaft të rëndësishëm në operat dhe oratoriot e tij. Koralet janë mjaft të pasura, me emocione të fuqishme dhe me karakter madhështor. Ndër to përmendim: oratorion “Juda Makabe”, koralen e famshme “Aleluja” nga oratorio “Mesia” etj. Më 1712-ën shkoi në Londër, ku u emërua dirigjent i Akademisë Mbretërore të Muzikës.



Hendel, Oratorio "Mesia" ➔

Aleluja

A - le - lu - ja, a - le - lu - ja, a - le - lu - ja, a - le - lu - ja, a -

le - lu - ja. A - le - lu - ja, a - le - lu - ja, a - le -

- lu - ja, a - le - lu - ja a - le - lu - ja. etj.



Portofoli yt

- Kërkoni nga burime të ndryshme informacioni (media, biblioteka, interneti) kuriozitete lidhur me këta kompozitorë.



13 Kur bie fyelli e çiftelia



Dëgjo dhe diskuto

rreth këngës "Kur bie fyelli e çiftelia". Shkruaj katër emra instrumentesh muzikore popullore të krahinës ku banon. Po ti, a luan në ndonjë instrument muzikor?

- I -

Kur bien fyelli, çiftelia,
natën deri von',
vet' nga zemra k'ndon malsia,
krenaria jon'.

Ti, o fyell' i barinjve,
bukur po ting'llon,
si kristalet nëpër kroje,
zëri yt buron.

- Refreni -

Bjeri çiftelis', o djal',
këng' e trimave t'ushtoj',
kur bien fyelli e çiftelia,
natën deri von',
vet' nga zemra k'ndon malsia,
krenaria jon'.

- II -

Me dy tela çiftelie,
këngën do qëndis,
do këndoj nëpër koriye,
shkrepave t'malsis'.

Kënga ime dhe jehona,
maleve t'ushtoj',
të gëzohen bjeshkët tona,
krenaria jon'.

- Refreni -

Bjeri çiftelis', o djal'...



Ansambli Popullor dhe Ansambli i Kosovës "Shota", së bashku në Gjirokastrë

Kur bie fyelli e çiftelia

Allegretto

Muzika: Pjetër Gaci

Teksti: A. Banushi

Kur bien fye - lli, çif - te - li - a na - tën de - ri von' vet' nga zem - ra

k'non mal - si - a kre - na - ri - a jon'. Ti o fy - ell i ba - rinj - ve bu - kur po ting'

- llon vet nga zem - ra k'non mal - si - a kre - na - ri - a jon'.

Bje - ri çif - te - lis, o djal' këng' e tri - ma - ve t'ush

- toj' kur bie fye - lli çif - te - li - a na - tën de - ri

von' vet' nga zem - ra k'non mal - si - a kre - na - ri - a jon'.



Portofoli yt

- Përshkruani një ngjarje kulturore që është zhvilluar në qytetin apo krahinën tuaj.


Veçoni dy momente:

- llojin e ngjarjes muzikore;
- skenografinë ku zhvillohet ngjarja muzikore.




14 Luajmë në instrument

Luaj me bllokflaut



1


Allegretto



2

Allegro

KANON



- **Luj** melodinë e mëposhtme me dy bllokflaut ose dy fyej.

3

Melodi - Bullgare

F. I

F. II

F. I

F. II

F. I

F. II

F. I

F. II



15 Kultura muzikore gjatë Klasicizmit



Dëgjo dhe diskuto

fragmentin muzikor të shkëputur nga “Simfonia nr. 3, Heroike” e Bethovenit. Sill një fakt interesant nga njohuritë që ke marrë në lëndën e historisë rreth Revolucionit Francez.



Iluminizmi është lëvizje që mbizotëroi në shekullin XVIII, veçanërisht në gjysmën e dytë të tij, dhe kishte si synim kryesor “ndriçimin e mendjes njerëzore” nëpërmjet shkencës dhe artit. Iluminizmi ishte lëvizje ideo-artistike në Evropë që tregonte gjendjen shpirtërore, zhgënjimin dhe pakënaqësinë ndaj realitetit ekzistues, e cila shprehej në forma dhe mënyra të larmishme.

Ky shekull u karakterizua nga një sërë ndryshimesh ekonomiko-shoqërore, që ndodhën si pasojë e revoltave popullore, të cilat arritën kulmin me revolucionin francez (1789) dhe atë amerikan (1776-1783). Filozofia iluministe u përhap në të gjitha fushat e shkencës dhe të kulturës. Fundi i shekullit XVIII përkon me periudhën e Klasicizmit në muzikë. Gjatë kësaj periudhe, arti muzikor fitoi tipare të reja, duke arritur kulmin e tij me përsosjen e simfonisë, në formë dhe përmbajtje, dhe me lindjen e një koncepti muzikor të ri e të rëndësishëm, siç ishte sonata klasike. Po në këtë periudhë, opera u zhvillua më tej, duke u kthyer në gjininë e parapëlqyer nga shtresat e larta shoqërore.

Opera seria (serioze) ishte opera tipike e periudhës së Klasicizmit, e cila pati një zhvillim të rëndësishëm, sidomos në strukturë dhe gjuhë muzikore. Kompozitori Kristof Vilibald Gluk (Christoph Willibald Gluck) njihet si reformator i operës *seria*. Vepra e tij solli ndryshime në idetë, përmbajtjen dhe konceptimin muzikor e dramatik të operës. Muzika u vu në shërbim të tekstit dhe u thjeshtua nga zbukurimet e panevojshme vokale, kurse uvertura u përdor për përgatitjen e dramës së operës.



“Napoleon Bonaparte”, pikturë nga Zhak Lui David



Opera buffa

Opera buffa (komike) u përfaqësua me kompozitorin Moxart, i cili është më i njohur për operat komike si: “Martesa e Figaros” (*Le Nozze Di Figaro*), “Don Xhovani” (*Don Giovanni*), “Kështu bëjnë të gjitha” (*Così fan' tutte*), si dhe “Flauti magjik” (*Die Zauberflöte*), si një pikë referimi në traditën gjermane.


Gjithashtu, gjatë Klasicizmit u zhvilluan më tej gjini të reja, si *simfonia*, *sonata*, *trioja* etj. dhe u përcaktuan qartë format e tyre.

Klasicizmi Klasicizmi njihet si periudha e formave të qarta, të rregullta, simetrike, me përmbajtje të lirë dhe më afër njerëzores. Klasicizmi është një nga periudhat më të zhvilluara të muzikës klasike. Klasikja nënkupton vlerën e përhershme dhe kjo më së miri evidenton rëndësinë e kësaj periudhe edhe në muzikë. Vjena kryeqyteti i Austrisë ishte qendra më e madhe në të cilën kultivohej ky stil e në të cilin jetonin tre kompozitorët e njohur si Treshja Vjeneze (Hajden, Mozart dhe Bethoven). Në kuadër të krijimtarisë së tyre arrihet kulminacioni zhvillimor i klasikizmit, duke i bërë këta tre kompozitorë reprezentuesit më të mëdhenj botëror të këtij stili në muzikë. Tri nga format kryesore muzikore të cilat kompozoheshin dhe gëzuan popullaritet të madh në klasikizëm ishin: sonata, simfonia dhe koncerti solistik.



"Konzert për flaut i Frederikut të Madh në Sansuçi", Adolf Menzel (Adolph Menzel)

Sonata vjen nga gjuha latine sonare – tingull/muzikim, dhe është formë muzikore (muzikën klasike) e cila përbëhet nga disa pjesë dhe interpretohet nga një instrument i vetëm apo nën përcjellje të një apo më shumë instrumenteve.



Simfonia, si edhe sonata, simfonia është vepër instrumentale, por në interpretimin e të cilës përfshihet tërë orkestra.

Koncerti solistik është vepër muzikore e cila interpretohet nga një instrument solo dhe orkestra simfonike.

Instrumentet muzikore u përsosën dhe u pasuruan me prurje të reja, si pianoja dhe klarineta. Klasicizmi muzikor njihet ndryshe edhe si klasikizmi vjenetz, pasi gjatë kësaj kohe, Vjena u bë qendra e zhvillimit muzikor. Aty u krijua shkolla klasike e simfonisë me kompozitorë të shquar të kohës.



Portofoli yt

- **Kërko** të dhëna nga burime të ndryshme informacioni në lidhje me ngjarjet kulturore, politike apo shkencore që ndodhën gjatë periudhës së Klasicizmit. Veço dy momente kyçe të kësaj periudhe, duke sjellë fakte, fotografi, vepra artistike, përfaqësues, ngjarje etj.



16 Përfaqësues dhe vepra muzikore

Përfaqësuesit më të shquar të Klasicizmit ishin kompozitorët e mëdhenj të shkollës vjeneze: Franc Jozef Hajden (*Franz Joseph Haydn*), Wolfgang Amadeus Moxart (*Wolfgang Amadeus Mozart*) dhe Ludvig van Bethoven (*Ludwig van Beethoven*). Ata mbajtën gjithë peshën e ndryshimeve dhe të zhvillimeve progresive të epokës së tyre, e cila mëtonte risi muzikore.

Franc Jozef Hajden (1732-1809) lindi në Rorau të Austrisë. Në moshën 8-vjeçare u transferua në Vjenë, ku filloi të këndonte në korin e Katedrales së Shën Stefanit dhe mori formimin profesional. Ai studioi kanto, violinë, klavijembal dhe kompozicion. Që nga viti 1761 e më pas, Hajdeni punoi rreth 30 vjet si drejtues orkestre dhe kompozitor në oborin e princit Esterhazy. Pas vdekjes së princit, shkoi në Londër, ku ia doli të bëjë jetën e një muzikanti të pavarur. Gjatë kësaj kohe, ai kompozoi 12 simfonitë e tij, që morën emrin "Simfonitë londineze". Hajdeni, i quajtur ndryshe edhe babai i simfonisë dhe i muzikës instrumentale, la një krijimtari të pasur me mbi 100 simfoni. Vdiq në Vjenë, më 1809.




Franc Jozef Hajden



F.J.Hajden "Simfonia nr.46" ➔

Simfonia 46





Volfgang Amadeus Mozart

Wolfgang Amadeus Mozart (1756-1791) lindi në Salzburg të Austrisë. Edukimi muzikor e mori nën udhëheqjen e të atit, i cili ishte violinist dhe dirigjent. Në moshën gjashtëvjeçare, ai ishte një virtuoz i njohur në të gjithë Evropën dhe, mbas disa vitesh, një kompozitor i sigurt dhe me plot besim në aftësitë e veta. Disa nga operat e tij më të suksesshme që luhen edhe në ditët tona janë: “Dasma e Figaros”, me libret të Pier Bomarshesë (*Pierre Beaumarchais*), “Don Zhuan”, me libret të Lorenzo da Pontes (*Lorenzo Da Ponte*), “Cosi fan’tutte” ose “Kështu bëjnë të gjitha”, “Flauti magjik” etj. Opera “Flauti magjik” dhe “Rekuiem” janë dy veprat e tij të fundit, nga të cilat “Rekuiem”, një vepër fetare e përmasave të mëdha, mbeti e papërfunduar. Ai vdiq më 5 dhjetor 1791, në një gjendje të mjerueshme dhe i pavlerësuar nga shoqëria aristokrate e kohës. Gëte ka thënë për të: “Një fenomen si Mozart është i pashpjegueshëm”.



V.A.Mozart opera "Flauti magjik" ➡



Ludvig van Beethoven

Ludvig van Beethoven (1770-1827) është një nga personalitetet më të shquara të muzikës. Lindi në Bon të Gjermanisë, ku mori dhe edukimin muzikor, nën nxitjen e të atit. Më 1792-shin, me ftesë të Hajdenit, shkoi në Vjenë dhe shumë shpejt u bë i famshëm në Evropë si pianist dhe kompozitor. Beethoveni vuri themelet e stilit të ri muzikor pianistik. Stili i tij i interpretimit ndryshonte shumë nga i të tjerëve, pasi ishte modern, plot teknikë dhe virtuozyt. Përveç muzikës, ai studioi edhe letërsi, histori e filozofi. Veprat e Shillerit, të Shekspirit, të Plutarkut, të Homerit, të Rusoit dhe të Gëtes e tërhoqën veçanërisht. Më 1802-shin, ai filloi të punonte për “Simfoni nr. 3”, kushtuar mikut të tij Napoleonit, të cilën e quajti “Simfonia heroike”. “Simfonia nr. 5”, e quajtur ndryshe “Simfonia e fatit”, është një ndër më të famshmet e Beethovenit. Me “Simfoninë nr. 9”, Beethoveni u bë kompozitori i parë që kombinoi orkestrën me korin.

Kjo simfoni u luajt në një nga sallat e koncerteve të Vjenës me dirigjent vetë Beethovenin, i cili në këtë kohë qe pothuajse e kishte humbur dëgjimin. Krijimet e tij, që përfshijnë 9 simfoni, një koncert për violinë, 5 koncerte për piano, 32 sonata për piano, 16 kuartete harqesh, sonata për violinë e violonçel, një opera, shumë uvertura etj., përbëjnë një thesar të artit muzikor botëror.



L.V.Beethoven "Sonata e hënës" ➡



Portofoli yt

- Kërkoni nga burime të ndryshme informacioni (media, biblioteka, interneti) kuriozitete lidhur me këta kompozitorë.



17 Intervista muzikore

Intervista ka si qëllim të mbledhë informacion në lidhje me interesa të caktuar. Muzika është një prej tyre. Për të marrë një informacion sa më të saktë, duhen pyetur njerëz të brezave të ndryshëm.

Intervista



1. Cili është zhanri i muzikës që preferoni më tepër: e lehtë, klasike apo popullore?



2. Sa orë në ditë i kushtoni dëgjimit të muzikës suaj të parapëlqyer?



3. Cili është programi muzikor që preferoni të ndiqni në TV?



4. Cila është shtëpia diskografike që realizon produksione më serioze, sipas mendimit tuaj?



5. A i kushton televizioni hapësirë të mjaftueshme muzikës në përgjithësi?



● **Plotëso** fjalëkryqin. Fjalët e mëposhtme do të të ndihmojnë ta zgjidhësh sa më saktë.

				S		N		T	A								
			M				E		I								
		I		R		V			O								
	P		E	A			S		M	F		N		K	E		
			S	I		A											
		O	P	R							O	P			E		A
K			C		T	I				S		L	I				K
	S		M	F	O		I	A			B		L		D		
				P			L			I		T		K	A		
					F			T		I							
		I				R	U		N								
			R			I	T		T		I						
					R		T		R								
					V		K		L	E							

SIMFONIA

POEMA SIMFONIKE

IMPROVIZO

SONATA

KONCERTI SOLISTIK

FANTAZIA

PRELUDI

OPERA

SUITA

MINUETI

OPERETA

BALADA

TOKATA

VOKALE

ORATORIO

INSTRUMENTI

RECITATIVI



18 Interpretues shqiptarë

Blerim Grubi, violinist. Studimet i mbaroi në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup, në klasën e prof. L. Gospodinov. Magjistroi në vitin 1999. Ka qenë pjesëmarrës i rregullt i festivaleve "Vera e Ohrit", "Ditët e Muzikës Maqedonase", Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës Kamertale në Prishtinë. U prezantua edhe në koncertet e organizuara nga UNICEF-i në Shkup dhe Osjek. Është violist-udhëheqës pranë Filharmonisë Maqedonase. Ndoqi kurse perfeksionimi në "Academia Chigiana" në Siena të Italisë të violisti i shquar botëror, prof. Jurij Bashmet. Ka koncertuar në Maqedoni, Shqipëri, Kosovë, Francë, Spanjë. Aktualisht është ligjërues në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, si dhe në Fakultetin Pedagogjik të Shkupit. Është udhëheqës i violave në Orkestrën Harkore të Filharmonisë së Kosovës dhe violist i Ansambllit Vivendi.



Blerim Grubi

Andante & Allegretto - Blerim Grubi ➡



Visar Kuçi

Austri, Belgjikë, Holandë, Bosnjë-Hercegovinë, si dhe në Kosovë.

Visar Kuçi lindi më 1983, në Prishtinë. Ai është violinist dhe është marrë me muzikë që në moshën 9-vjeçare, duke eksploruar dhe më pas duke zotëruar instrumente të ndryshme si violina, kontrabasi, kitara, bas-kitara. Ai ka studiuar në shkollën e muzikës "Prek Jakova", Prishtinë, ndërsa studimet universitare i ka kryer në Mynster të Gjermanisë, në Fakultetin e Artit Muzikor të Universitetit "Westfälischen Wilhelms".

Kuçi ka interpretuar në shumë koncerte si solist dhe në ansamble të ndryshme në Gjermani, Itali,

Mendelssohn-Violin Concerto in E minor Op.64 3-rd mov. played by Visar Kuci ➡





Venera Mehmetagaj-Kajtazi

Venera Mehmetagaj-Kajtazi (1960) është flautiste nga Kosova. Ajo ka zhvilluar koncerte si soliste në: Opati, Beograd, Zagreb, Rovinj, Sarajevë, Novi Sad, Dubrovnik, Gjermani, Spanjë, Slloveni, Turqi, Shqipëri, Maqedoni dhe Francë. Është specializuar në Francë dhe Shqipëri, si dhe u magjistrua në klasën e Nikola Atanasov.

Venera Mehmetagaj-Kajtazi përfaqësoi ish-Jugosllavinë në Festivalin Botëror për të rinjë në Havana të Kubës dhe në Kongresin Botëror të muzikantëve të rinj në Zagreb. Që nga mosha 14-vjeçare ka qenë soliste për vite me radhë në Orkestrën Simfonike të RTP-së dhe ka ekzekutuar si soliste në Lojërat Verore të Dubrovnikut, në Opati, Mal të Zi, Shqipëri etj.


Ajo ka luajtur solo në koncerte me Orkestrën Simfonike të RTSH-së, Orkestrën Filharmonike të Shkupit, Orkestrën Simfonike të Nishit dhe në Beograd, Orkestrën Simfonike të Zagrebit, me prezantime të shumta për RTV-në e Zagrebit; me Orkestrën Simfonike Shtetërore të Turqisë në Izmir, Ansamblin Kamertal "AMRA", Ansamblin Kamertal të Tiranës, si dhe me Orkestrën Filharmonike të Kosovës.

Venera Mehmetagaj Kajtazi - Csardas, Vittorio Monti ➞



Portofoli yt

- **Kërko** të dhëna nga burime të ndryshme informacioni në lidhje me veprimtarinë artistike të dy instrumentistëve apo këngëtarëve kosovarë.
- **Sill** fakte, fotografi nga ngjarje artistike të perfomuar nga këta artistë.



Verifiko njohuritë

1

Rendit disa nga format apo gjinitë muzikore që u krijuan dhe u zhvilluan gjatë periudhës së Barokut.

2

Shkruaj duke përdorur hartën e koncepteve rreth periudhës së Klasicizmit, ngjarjeve, përfaqësuesve, veprave muzikore, krijimit të shkollave kombëtare etj.

3

Zgjero njohuritë


1. Kërko nga burime të ndryshme të dhëna rreth jetës dhe veprimtarisë së Bethovenit, duke renditur dy fakte rreth tij.

2. Rendit dy nga veprat muzikore sipas gjinive të krijuara gjatë kësaj periudhe nga ky kompozitor.

3. Shkruaj disa fjali, duke shprehur me gjuhë të thjeshtë muzikore përshtypjet e tua mbi emocionet e veprave muzikore të parapëlqyera.

4

Lidh me shigjetë kompozitorin me titullin e veprës muzikore që ai ka kompozuar.



Oratorio "Mesiah"



"Tokata & Fuga D minor"



"Stinët e Vitit"



Opera "Ariana"



"Sonata e Hënës"

Muzika në periudhën baroke

Për realizimin e projektit, duhet:

1. të punohet vetëm dhe në grup;
2. të kërkohet informacion nga burime të ndryshme (libra, internet);
3. të përdoren teknologji të ndryshme për marrjen e të dhënave dhe organizimin e tyre;
4. të paraqiten punimet në mënyrë të kuptueshme për të gjithë;
5. të krijohen prezantime në *PowerPoint*, CD, DVD.

Hapat për realizimin e projektit

Ndarja e grupeve sipas interesave dhe njohurive:

Grupi i historisë bën kërkime rreth zhvillimeve historike gjatë viteve 1600-1750 dhe sjell të dhëna të ndryshme: data, fakte, përfaqësues, ngjarje etj.



Grupi i letërsisë dhe arteve të tjera bën kërkime dhe sjell të dhëna për:

1. lëvizjet artistike të kohës;
2. karakteristikat e artit të kësaj periudhe;
3. autorët dhe veprat e tyre.

Grupi i muzikës bën kërkime rreth zhvillimit të muzikës dhe sjell të dhëna për:

1. ndryshimin dhe zhvillimin e muzikës në krahasim me periudhën paraardhëse;
2. mënyrat e reja të shkrimit muzikor;
3. stilet dhe gjinitë e reja muzikore;
4. përsosjen e violinës dhe të instrumenteve të tjera;
5. kompozitorët dhe veprat e tyre muzikore.



Antonio Stradivari (pikturë, autor i panjohur)



- **Të gjitha grupet** përgatisin një prezantim shpjegues për punimin (në *PowerPoint*) dhe i sjellin materialet në CD apo DVD.

Rezultatet e arritura

Nxënësit/et:

- sjellin informacion mbi historinë e viteve 1600-1750; Republikën e Kromuellit dhe mbretërimin e Luigjit XIV;
- paraqesin dhe diskutojnë në grup materialet e gjetura;
- përzgjedhin materialin e duhur dhe e përgatisin për prezantim;



Hyacinthe Rigaud: Portret i Luigjit XIV



- sjellin informacion mbi zhvillimin e letërsisë dhe të arteve të kësaj periudhe;
- rendisin karakteristikat e letërsisë dhe të arteve të tjera të kësaj periudhe;
- sjellin dokumente, fakte biografike, historike dhe vepra për autorët e letërsisë dhe të arteve të kësaj periudhe;
- paraqesin dhe diskutojnë në grup materialet e gjetura;
- përzgjedhin materialin e duhur dhe e përgatisin për prezantim;

- sjellin informacion mbi zhvillimin e muzikës së kësaj periudhe;
- renditin karakteristikat e muzikës baroke: shkrimin muzikor, gjinitë e reja, instrumentet e përdorura etj.;
- sjellin dokumente, fakte biografike, historike dhe vepra për kompozitorë të ndryshëm të kësaj periudhe;
- përzgjedhin veprat dhe incizimet më të pastra audio të kompozitorëve të kohës, sipas parapëlqimeve të tyre;
- paraqesin dhe diskutojnë në grup materialet e gjetura;
- përzgjedhin materialin e duhur dhe e përgatisin për prezantim;



Faqja e parë e partiturës nga vepra "Primavera" (4 Stinët) e Antonio Vivaldit



- përfundojnë punimin me një prezantim shpjegues mbi zhvillimin e muzikës në periudhën baroke;
- paraqesin në një CD apo DVD vepra muzikore të periudhës baroke: koncerte për violinë, kantata, oratorio, opera etj.



Opera "Rigoletto" vënë në skenë nga trupa e Teatrit Shtetëror të Operës dhe Baletit të Dnipropetrovskit, Dnjepër, Ukrainë (2016)

Njësia mësimore 19: Kultura muzikore në Romantizëm

Njësia mësimore 20: Përfaqësues dhe vepra muzikore

Njësia mësimore 21: La donna e mobile

Njësia mësimore 22: Krijues dhe interpretues shqiptarë

Njësia mësimore 23: Muzika në shekullin XIX/XX

Njësia mësimore 24: Përfaqësues dhe vepra

Njësia mësimore 25: Luajmë në instrument

Njësia mësimore 26: Njerëzit e agimeve

Njësia mësimore 27: Muzika moderne, rryma dhe përfaqësues

Njësia mësimore 28: The final countdown

Verifiko njohuritë

Projekt 2: Jeta dhe vepra e një kompozitori



Aftësitë e nxënësit/es:

- **këndon** këngët në ritmet dhe tonalitetet e mësuara;
- **krijon** në ritmet e mësuara, duke përdorur simbolet muzikore përkatëse;
- **plotëson** më tej njohuritë mbi zhvillimin e muzikës postromantike, përfaqësuesit, veprat dhe krijimet përmes ngjarjeve kulturore;
- **dëgjon** muzikë dhe përjeton emocionet që përcjell ajo;
- **zbulon** ndjesitë që krijon muzika dhe i përshkruan ato;
- **reflekton** ndaj muzikës që dëgjon, si pjesë e kohës në të cilën u krijua;
- **përdor** njohuritë për të krijuar ese, tema projektesh të ndryshme etj., individualisht ose në grup.



Fjalë kyçe:

verizmi, ekspresionizmi, impresionizmi, muzika moderne, rokenroll, hard-roku, regjistrim, miksim, master, kompakt disk, magnetofon, kasetofon, radio, televizor, celular, QR code.



19 Kultura muzikore gjatë Romantizmit



Dëgjo dhe diskuto

fragmentin muzikor të shkëputur nga “Vallet hungareze” të kompozitorit Johanes Brahms dhe përshkruaj ndjesitë dhe emocionet që të krijon muzika.



Romantizmi është një lëvizje ideo-artistike, që u zhvillua gjatë shekullit XIX, e cila përfshiu letërsinë, teatrin, pikturën dhe muzikën.

Artet po ndërthureshin ndërmjet tyre, pavarësisht formës dhe mënyrës së shprehjes. Muzika u mbështet në subjektet e romanit, piktura paraqiste figura të letërsisë dhe poezia fitoi muzikalitet. Në pikturë, muzikë e letërsi filluan të zënë vend gjithnjë e më shumë ngjarjet historike. Personaliteti

i njeriut u vu në qendër të vëmendjes së artit romantik. Kompozitorët u mbështetën në elementet origjinale të folklorit muzikor, në meloditë e ritmet popullore, në format e të shprehurit muzikor, shfaqjet muzikore popullore dhe muzikën instrumentale popullore.

Këngët popullore u bënë bazë e stileve të ndryshme muzikore, e formave dhe e gjinive instrumentale, vokale, simfonike e skenike. *Nacionalizmi* ishte një nga tiparet e rëndësishme të Romantizmit, gjë që çoi në formimin e shkollave kombëtare romantike. Në gjysmën e parë të shekullit XIX, u krijua shkolla *polake* me përfaqësues Frederik Fransua Shopenin (Frédéric François Chopin). Shkolla *ruse* e filloi rrugën e saj me kompozitorin Mikhail Ivanoviç Glinka (Mikhail Ivanovich Glinka) dhe arriti një nga kulmet e saj me Pjotr Iliç Çajkovskin (Pyotr Ilyich Tchaikovsky). Shkolla *hungareze* u përfaqësua nga Franc List (Franz Liszt), ndërsa shkolla *çeke* nga Bedrizh Smetana (Bedřich Smetana) dhe Antonin Dvorzhak (Antonín Dvořák). Në gjysmën e dytë të shek. XIX, në vendet skandinave u krijua shkolla *norvegjeze* me përfaqësues Edvard Grig (Edvard Grieg) dhe ajo *finlandeze* me përfaqësues Jan Sibelius (Jean Sibelius). Gjatë Romantizmit u zhvilluan:

- krijimi i lirë dhe i pavarur;
- stili individual dhe ai kombëtar;
- shkollat kombëtare;
- gjini dhe forma të reja muzikore;
- muzika me program.

Zhvillime të reja pati në **opera**, **balet** dhe **muzikë simfonike**. Kompozitorët më të shquar të kësaj periudhe ishin: Franc Shubert (Franz Schubert), Robert Shuman (Robert Schumann), Nikola Paganini (Niccolò Paganini), Feliks Mendelson (Felix Mendelssohn), Franc List, Frederik Shopen etj. *Muzika pianistike* zuri një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tyre. Gjinitë dhe format klasike pësuan ndryshime, si dhe njëkohësisht lulëzuan gjini dhe forma të reja muzikore të palëvruara më parë, si: *miniatura*, *mazurka*, *nokturni*, *polonezja*. Nëpërmjet sonatës dhe simfonisë, muzika instrumentale



Baleti "Liqeni i mjelmave", P. I. Çajkovski

zhvilloi më gjerë idetë, temat dhe subjektet e ndryshme të kohës. Muzika me program zuri një vend të rëndësishëm. Ajo është vepër muzikore që mbështetet mbi një tekst letrar, por nuk e citon atë, vetëm i merr idenë, p.sh.: baleti “Ëndrra e një nate vere” nga vepra e Shekspirit ose tri albumet me pjesë (miniaturat) të quajtura “Vitet e udhëtimeve” të Listit etj.



Shopeni duke luajtur në piano në sallinin e pallatit të princit Raxhivill në Berlin (pikturë nga H. Shemiracki).



Provo aftësitë muzikore

1. Plotëso fjalinë e mëposhtme me të dhënat përkatëse.

Gjatë Romantizmit u zhvilluan:

▶ krijimi i lirë dhe i pavarur;



2. Rendit gjinitë e muzikës instrumentale që u zhvilluan gjatë Romantizmit.

3. Shkruaj një përfaqësues për çdo shkollë kombëtare që u krijua.

Shkolla ruse _____


Shkolla çeke _____

Shkolla finlandeze _____

Shkolla hungareze _____

Shkolla norvegjeze _____

4. Gjej dhe **shkruaj** emrin e kompozitorit, duke vëzhguar fotografitë e mëposhtme.





20 Përfaqësues dhe vepra muzikore



Franc Shubert

Franc Shubert (Franz Schubert) (1797-1828) lindi në Lihtental të Vjenës. Edukimi muzikor nuk i mungoi asnjëherë, pasi e gjithë familja e tij luante bashkë në kuartet. Duke qenë pjesëtar i orkestrës së shkollës, ai u njoh me veprat e Moxartit, të Hajdenit dhe të Bethovenit. Shuberti krijoi liedin (romancën vokale), që u shndërrua në një gjini muzikore karakteristike të kohës. Në moshën 17-vjeçare, kompozoi simfoninë e tij të parë dhe disa këngë, ndër të cilat spikat “Margarita në çikrik” nga “Fausti” i Gëtes. Me “Simfoni nr. 8” (e pambaruar), ai njihet si krijuesi i simfonisë romantike. Vepra të tjera të tij janë ciklet me këngë “Mullixhesha e bukur”, “Rrugë dimërore” etj. Ai pati një jetë të vështirë dhe vdiq në moshë të re, për shkak të sëmundjeve.

F.Shubert "Serenata" ➡



Hektor Berlioz

Hektor Berlioz (1803 -1869) lindi në Francë. Edhe pse prindërit e tij dëshironin që ai të bëhej mjek, Hektori iu përkushtua mësimëve të muzikës, duke ndjekur Konservatorin e njohur të Parisit. Hektor Berlioz ishte kompozitor, dirigjent dhe shkrimtar i muzikës, aftësi të cilat ai i përdori me orgjinalitet duke i dhënë një drejtim të ri muzikës franceze. Krijimtaria e tij u bë nismëtare e muzikës romantike me program dhe sidomos e gjinisë së simfonisë duke krijuar kontraste të forta muzikore. Një nga kryeveprat e tij është “Simfonia fantastike”, ndër vepra të tjera të kompozura nga ky kompozitor janë vepra orkestrale “Haroldi në Itali”, “Romeo dhe Zhuljeta”, uvertura “Mbreti Lir”, “Karnavali i Romës” etj.

H.Berlioz "Simfonia fantastike" ➡



Pjotr Iliç Çajkovski

Pjotr Iliç Çajkovski (1840-1893) ishte një kompozitor i rëndësishëm rus, dirigjent e pedagog. Muzika e tij shquhet për karakterin kombëtar, për harmoninë e pasur dhe meloditë energjike. Ai shkroi në të gjitha gjinitë e muzikës (koncerte për piano dhe orkestër, koncert për violinë dhe orkestër, simfoni, romanca vokale etj.), por u bë i njohur sidomos në gjininë e baletit me vepra si: “Arrëthyesi”, “Bukuroshja e fjetur”, “Liqeni i mjellmave” etj.

P.I.Çajkovski "Liqeni i mjellmave" ➡





Franc List

Franc List (Franz Liszt) (1811-1886) është quajtur ndryshe “poeti i pianos”. Ai lindi në Raiding të Hungarisë dhe studioi për piano dhe kompozicion në Vjenë. Në vitin 1823, u vendos në Paris, ku zhvilloi një aktivitet të gjerë koncertal si pianist virtuoz dhe si interpretues i veprave pianistike. Veprimtaria si pianist, pedagog, kompozitor dhe dirigjent e bëri Listin një ndër figurat më të spikatura të botës muzikore evropiane. Krijimtaria e tij përfshin rreth 700 vepra muzikore, si vepra simfonike, pianistike, vokalo-instrumentale etj. Në fushën e muzikës pianistike ka shkruar tri albume, etyde për piano, sonatë, dy koncerte për piano dhe orkestër, 19 rapsodi hungareze të mbështetura në këngë, valle ose marshe cigane etj. Listit i njihet merita e zhvillimit dhe e përsosjes së teknikës pianistike.



F.List "Kampanela" ➔

Kampanela

Franc List

Allegretto

p

8va

p ma sempre ben marcato

il tema

8va



21 La donna è mobile



Dëgjo këngën dhe diskuto

duke veçuar këngëtarin e muzikës operistike që ju pëlqen më shumë.

La donna è mobile
qual piuma al vento,
muta d'accento
e di pensiero.

Sempre un amabile,
leggiadro viso,
in pianto e riso,
è menzognero.

La donna è mobil'
qual piuma al vento,
muta d'accento
e di pensier'!



Fotografi e shkëputur nga opera "Rigoletto" e Xh. Verdit



A e dini se...

Opera "Rigoletto" e Xhuzepe Verdit u vu në skenë për herë të parë në teatrin e operës në Venecia, më 11 mars 1851 dhe pati menjëherë shumë sukses.

Rolet

Rigoletto, gaztor i dukës
Xhilda, e bija e Rigoletos
Duka i Mantovës
Sparafuçile, vrasës
Madalena, motra e tij
Xhovana, kujdestarja e Xhildës
Konti Çeprano
Kontesha Çeprano, e shoqja
Mateo Borsa, oborrtar

Lloji i zërit

bariton
soprano
tenor
bas
kontralto
mexosoprano
bas
mexosoprano
tenor

Rolet

Konti Monterone

Marulo

Shërbëtor i oborrit

Shërbyese

Kori i burrave: oborrtarë të dukës dhe të ftuar

Lloji i zërit

bariton

bariton

bas

mexosoprano

La donna è mobile

Allegretto

Muzika: Xhuzepe Verdi




La do - nna è mo - bi - le qual piu ma al ven - to,
Sem - pre un' a - ma - bi - le leg - gia - dro vi - so



mu - ta d'ac - cen - to e di pen - sie - ro
in pian - to o in ri - so è men - zo - gne - ro



La don - na è mo - bil' qual piu - ma al ven - to



mu - ta d'acc - en - to e ³ di pen - sier'.




Portofoli yt

● **Kërko** informacion nga burime të ndryshme, duke krijuar një historik lidhur me ngjarjet në të cilat zhvillohet opera. Historiku mund të zhvillohet:

- duke kërkuar rreth jetës dhe veprimtarisë së kompozitorit dhe libretistit të operës;
- duke kërkuar rreth jetës dhe veprimtarisë së një këngëtarit tënd të parapëlqyer, që zhvillon veprimtarinë e vet në gjininë e operës, shqiptar apo i huaj.



22 Krijues shqiptarë



Tish Daija

Tish Daija lindi më 1926, në Shkodër. Kompozimet e tij të para janë këngët: “Çik, o mori çikë”, “Ndal, bre vash”, “Me lule të bukura” etj. Shkollën e mesme e kreu në vitin 1947, në qytetin e lindjes, ndërsa studimet e larta më 1956-ën, në Konservatorin “Çajkovski” të Moskës. Kompozitori i shquar shqiptar është një nga themeluesit e Konservatorit të Tiranës, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ai mban titullin e lartë “Artist i Popullit”. U nda nga jeta më 3 tetor 2004.

T. Daija, baleti “Halili dhe Hajria” ➡



Kujtim Laro

Kujtim Laro lindi në Vlorë, më 8 maj 1947. Qyteti i tij i lindjes, aty ku bregdeti i Jonit, polifonia dhe elegjitet e këtij qyteti do të bëheshin frymëzimi i tij deri në fund të jetës, i dha dëshirë dhe pasion për të shkruar muzikë. Studimet e larta i kreu në Institutin e Lartë të Arteve dhe u diplomua në vitin 1970. Më pas, u caktua të punonte pranë Akademisë së Arteve, si pedagog në degën e kompozicionit. Gjinitë më të dashura për të mbetën muzika e filmit dhe kënga. Rreth 27 filma të njohur artistikë, mbajnë firmën e tij për kolonën zanore. Krijimtaria e këtij kompozitori të madh nisi me muzikën e filmit “I teti në bronz” dhe përfundoi me kolonën zanore të filmit “Lule të kuqe, lule të zeza”, e cila është quajtur nga kolegët e tij si “kënga e fundit e mjellmës”. Ai ka kompozuar muzikë për filma, si: “Në fillim të verës”, “Lulëkuqet mbi mure”, “Udha e shkronjave”, “Liri a vdekje”, “Nëntori i dytë”, “Militanti”, “Vendimi”, “Yjet e netëve të gjata” etj. U nda nga jeta në vitin 2004.

K.Laro “Lulëkuqet mbi mure” ➡





Bashkim Shehu

Bashkim Shehu lindi më 1952, në qytetin e Pejës. Studimet për muzikë i bëri në Prishtinë, Sarajevë dhe specializimin për kompozicion në Paris. Është autor i një numri veprash orkestrale, vokale, solistike dhe kamerale, muzikës për film dhe teatër. Gjuha shprehëse muzikore e tij dallohet për shfrytëzimin e melosit popullor me elemente të njohura të muzikës bashkëkohore dhe me ato më të reja. Veprimtaria e tij është e larmishme si në Kosovë, ashtu edhe në Kroaci. Nga krijimtaria e tij veçojmë: “Refleksione” për kuartet harqesh, “Skica simfonike” për orkestër, “Loja e eshtrave” kantatë, “Elegji për Rexho Mulliqin”, “Të lindet njeriu” për kor, baleti “Besa”, muzikë për filmin “Lepuri me pesë këmbë”, vepra skenike etj. Kompozoi shumë këngë për fëmijë dhe për të rinj.



Esat Rizvanolli

Esat Rizvanolli (1936-2006), lindi në Gjakovë. Hapat e parë drejt muzikës i hodhi në vendlindjen e tij, për të vazhduar shkollën e mesme të muzikës në Prizren. Studimet universitare i përfundoi në Akademinë e Muzikës në Beograd, fillimisht në teori dhe pedagogji muzikore e më vonë për kompozim. Esat Rizvanolli ndoqi edhe studimet pasuniversitare në Konservatorin e Moskës. Veprimtaria e tij muzikore përbëhet nga vepra të formave dhe gjinive të ndryshme muzikore. Ai është tradicional për sa i përket stilit krijues. Nga veprat e tij dallojmë:

Veprat korale, madrigali, kor i përzier (1961), N’mjedis ballit ma ke një pikë etj.

Veprat vokalo-instrumentale: fjala e Skënderbeut, baritone, kor i përzier, recitator dhe orkestër (1968), Rezistenca 1943, Poema Simfonike, kor i përzier dhe orkestër (1973).

Veprat kamertale: suita darsmore, piano (1960), Adagio dhe Scherzo, piano (1961), Rondo rustico, piano (1961), Fuga me katër variacione, violinë dhe piano (1961-62), Peshkatari, violinë dhe piano (1960), Temë me 7 variacione, piano (1962), Kuartet harkor (1963), Valle e rëndë shqiptare, flautë, klarinetë, piano, kor i përzier dhe recitatorë (1993), Preaeludium, piano (1996).

Veprat orkestrale: poema simfonike (1974), Musica simfonica (1977), Koncert, violinë dhe orkestër (1985), Koncert, violinë dhe orkestër kamertale (1999).

Veprat e këtij kompozitori u interpretuan në Kosovë dhe jashtë saj, në vende të ndryshme të ish-Jugosllavisë.



E.Rizvanolli, "N’mjedis ballit ma ke një pikë" ➔



Portofoli yt

- **Zhvillo** pemën e muzikës kosovare dhe shqiptare, duke shkruar rreth krijimtarisë së tyre.
- **Veço** kompozitorin/en tënd/e të parapëlqyer.
- **Prezantoje** punimin tënd në klasë.



23 Muzika në shekullin XIX/XX



Dëgjo dhe diskuto

fragmentet muzikore nga “Rapsodia blu” e kompozitorit Xhorxh Gershuin (George Gershwin) dhe “Sonata e hënës” e Bethovenit. Përshkruaj me fjalë të thjeshta të përbashkëtat dhe të veçantat që dëgjon te secila vepër muzikore.



Në fundin e shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX, në Itali, u krijua një rrymë e re artistike e quajtur **Verizëm**. Verizmi është një rrymë pasromantike, e cila fillimisht lindi si lëvizje letrare. Verizmi në Itali përfaqësohet nga Pjetër Maskanji (Pietro Mascagni) (1863-1945). Vepra e tij veriste ishte opera “Kavaleria rustikane” me libret të Xhovani Vergës (Giovanni Verga), i cili ishte një nga shkrimtarët kryesorë të Verizmit. Në këtë vepër mbizotërojnë realiteti dhe ndjenja dramatike, si dhe paraqiten histori të vërteta në situata të parashikueshme, pa sentimentalizëm të tepërt. Kompozitorë të tjerë të kësaj periudhe janë: Umberto Xhordano (*Umberto Giordano*, 1867-1948), Ruxhero Leonkavallo (*Ruggero Leoncavallo*, 1857-1919), fama e të cilit është e lidhur me operën “Paliço”, Xhakomo Puçini (*Giacomo Puccini*, 1858-1924), suksesi i të cilit erdhi me operën “Manon Leskot” dhe vazhdoi me kryeveprën e tij operën “Bohema”.



Klod Mone (Claude Monet), “Perëndim”
(vepër e Impresionizmit)

Verizmi në Gjermani përfaqësohet nga Rikard Shtraus (*Richard Strauss*, 1864-1949) dhe Gustav Mahler (1860-1911), kompozitorë të cilët filluan të krijojnë një stil të ri muzikor. Shtrausi ndërtoi gjuhën muzikore, duke futur ironinë te poemat e tij simfonike, ndërsa Mahleri i zëvendësoi heronjtë e mëdhenj dhe idealet e mëdha wagneriane me njeriun e zakonshëm.

Fundi i shekullit XIX shënoi lindjen e disa lëvizjeve të reja artistike, ku më të rëndësishmet ishin **Impresionizmi dhe Ekspresionizmi**. Në Impresionizëm, kompozitori vë në qendër të vëmendjes tingullin dhe atmosferën që krijon muzika dhe jo formën e saj, siç ndodh në Klasicizëm dhe Romantizëm. Në Francë, Impresionizmi muzikor u modelua si stil, u zhvillua dhe arriti kulmin e tij me veprat e kompozitorit **Klod Debysi** (*Claude Debussy*, 1862-1918). Me një krijimtari të pasur muzikore për piano, shumë origjinale dhe novatore, Debysi konsiderohet mjeshtër i tingullit. Ai krijoi një gjuhë të re muzikore, e cila përjashtonte shumë rregulla tradicionale, duke sjellë prishjen e melodisë dhe largimin e saj nga burimi popullor, ashpërsimin e harmonisë dhe shfaqjen për herë të parë të akordeve disonante (të çrregullta). Kompozitorë të tjerë të kësaj periudhe janë: Moris Ravel (*Maurice Ravel*), Isak Albeniz (*Isaac Albéniz*), Xhon Alden Karpenter (*John Alden Carpenter*), Frederik Delius (*Frederick Delius*), Pol Djukas (*Paul Dukas*), Manuel de Fala (*Manuel de Falla*), Çarls Tomlinson Grifs (*Charles Tomlinson Griffes*), Otorino Respigi (*Ottorino Respighi*).

Xhorxh Gershuin (George Gershwin, 1898-1937) është një nga kompozitorët më të rëndësishëm amerikanë të shekullit XX. Disa nga veprat e tij më të njohura janë: “Rapsodia blu”, “Një amerikan në Paris” etj.



Xhorxh Gershuin

Dimitri Shostakoviç (Dmitri Shostakovich, 1906-1975), kompozitor dhe pianist rus, konsiderohet si një nga kompozitorët kryesorë të shekullit XX. Muzika e tij karakterizohet nga kontraste të mprehta, elemente groteske dhe ndikime të stilit neoklasik. Krijimtaria e tij përfshin: 15 simfoni dhe gjashtë koncerte, 15 kuartete me varg, një kuintet piano, dy sonata, 24 prelude dhe fuga, opera, balete, muzikë filmi. Një nga veprat e tij më të njohura është “Vals nr. 2 - op. 99”.

Në kohën kur jeton dhe krijon Shostakovic, ne kemi nje kompozitor të njohur shqiptar me emrin Shime Deshpali (1897-1981) i lindur në Arbresh të Zarës - Kroaci i lidhur me muzikën popullore shqiptare. Ishte kompozitor me tema popullore, pedagog muzikor, dirigjent i ansambleve amatore në Dalmaci si në Zarë, Dubrovnik.

Ai ishte poet dhe shkrimtar arbnes. Opusi i tij nuk ishte fort i madh. Ka përpunuar dhe stilizuar disa këngë popullore për kore. Mes tyre dallohen këto këngë: Dashnore tu bana moj Shaje, Oh ky Mehmeti, të gjitha për kore të përziera. Ka disa këngë në vargje: Lenës, Lulëzoi lulja, Këngë për kore fëmijësh.

Pjesë për piano si Dansi i lulës. Ka pak vepra orkestrale si: Funtoma, Upria, Moba, si dhe operën e papërfunduar Vana.



Dimitri Shostakoviç



D.Shostakoviç, “Valsi nr 2” ➡



Provo aftësitë muzikore

1. Kërko të dhëna rreth kompozitorit Xhorxh Gershuin. Bëj një përmbledhje të tyre, duke u përgjigjur pyetjeve që vijnë dhe duke shtuar fakte që të duken mbresëlënëse.

- ▶ Çfarë lloj muzike kompozoi Xhorxh Gershuin?
- ▶ Cili ishte instrumenti i tij i parapëlqyer?
- ▶ Cila vepër e bëri të famshëm?
- ▶ Pse e shkroi ai veprën “Rapsodia blu”?



Portofoli yt

● **Kërko** të dhëna nga burime të ndryshme informacioni, në lidhje me ngjarjet artistike, kulturore, politike apo shkencore që ndodhën gjatë shekujve XIX-XX.

● **Veço** dy momente kyçe të kësaj periudhe duke sjellë fakte, fotografi, vepra artistike, përfaqësues, ngjarje etj. Krijë një CD me vepra muzikore të zgjedhura të kompozitorëve të ndryshëm.



Bahri Çela

Bahri Çela ka studiuar në Konservatorin e Shën Petërsburgut në Rusi dhe në Nicë (Francë). Ai ka punuar në Radio Prishtina, ka qenë edhe udhëheqës i korit në shkollën e mesme të muzikës në Prishtinë. Është një ndër nismëtarët e themelimit të Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës, në vitin 1975. Si dirigjent i kësaj orkestre ka realizuar koncerte të rregullta me vepra të autorëve shqiptarë, por edhe botërorë.

Në vitin 2000, Bahri Çela bashkë me muzikantë të tjerë themeluan Filarmoninë e Kosovës.

Kreshnik Aliçkaj (1982) ka studiuar në Akademinë e Muzikës, dega e Pedagogjisë së Përgjithshme Muzikore, në Universitetin e Prishtinës, Kosovë. Ai është ndër kompozitorët që ka sjellë risi, duke futur lahutën në muzikën klasike. Shumë vepra të tij orkestrale kanë fituar çmime të shumta. Një nga veprat e tij simfonike u ekzekutua në shenjtërimin e Nënë Terezës, në Vatikan, në vitin 2016, ndërsa vepra "Piano Quintiles" e kompozuar për violinë, violonçel dhe piano fitoi çmimin e parë në konkursin ndërkombëtar për kompozitorë në Luksemburg. Po ashtu, zuri vendin e parë në konkursin ndërkombëtar të kompozitorëve "Artistes en herbe", në Luksemburg me veprën "Kuintet pianistik", e shkruar për dy violina, violonçel, dhe piano.



Kreshnik Aliçkaj




Drinor Zymberi

Drinor Zymberi (1987) është kompozitor i muzikës koncertale, me një repertor të gjerë interpretimesh në vende të ndryshme. Ka studiuar në Universitetin e Prishtinës (për kompozim). Që herët ka marrë pjesë dhe është evidentuar në konkurse të ndryshme për kompozitorët e rinj, për ta vijuar më pas jetën koncertore jo vetëm në kryeqytetet e Kosovës e Shqipërisë, por edhe në shumë qendra muzikore të Ballkanit dhe Evropës. Veprat që ka publikuar janë: Trance për orkestër harkore dhe Moving landscapes po për orkestër harkore. Gjithashtu ai është fitues i disa konkurseve të njohura për kompozim në Finlandë, Gjermani, Poloni dhe Itali.

Avazi i Tanës

Andante



Rafet Rudi

Rafet Rudi (1949) lindi në Mitrovicë. Shkollën e mesme të muzikës e mbaron në Prishtinë. Në vitin 1973 përfundon studimet në dirigjim. Më 1974 studioi për kompozim në Akademinë e Muzikës në Beograd. Veprimtaria krijuese e Rafet Rudit përfshin vepra të formave dhe gjinive të ndryshme muzikore, dhe disa prej tyre edhe janë publikuar dhe incizuar. Ai ka realizuar nje CD me Philip Loli, Ehat Musa, Marianne Delmas – Mondin etj. Rafet Rudi është drejtues i Korit të Filharmonisë së Kosovës. Nga veprat e tij krijuese do të veçojmë:

- **Veprat vokale - korale:** *Ishin dy kunata*, kor i përzier; *Lule gjaku*, kor i përzier; *O zemra ime ku vate*, solist dhe kor i përzier; etj.
 - **Veprat vokalo – instrumentale:** *Canti tradicionalit liturgjik*, 3 solistë, kor mistk, 2 flauta, organo dhe timpanë; *Flijimi*, solistë, kor i përzier, 3 kavalla, kontrabas, tupan, tam-tam; *Afresk Arbëresh III*, solistë, octet vocal, organo, piano katër duar, shiritë magnetikë; etj.
 - **Veprat kamertale:** *Suitë*, piano; *Variacione*, klarinetë, violinë dhe piano; *Kuartet harqesh*; *Prishtina blues*, piano; etj.
 - **Veprat orkestrale:** *Afresk arbëresh IV*, sopran dhe harkorë; *The Return*, mezzosopran dhe orkestër simfonik; *Dialog Concertant*, flaut dhe orkestër simfonik (2010).
- Rudi kompozoi edhe muzikë për teatër: *Ifigjenia në Aulidë* (1983), *Kali i Trojës* (1994), *Duke pritur Godonë* (1995), *Othello* (1995), *Odisea Shqiptare* (1998), *Fluturimi përmbi folenë e qyqes* (2000), *Orestija* (2003) si dhe për film: *Kohët e liga* (1997), *Dhimbja* (1997), *Fantazmat ladrojnë* (1998).





25 Luajmë në instrument




Luaj me bllokflaut

Luaj vetëm ose në grup ushtrimet në instrument.

Delja rudë






1

Mi b




Blokflaut 1

Blokflaut 2



2

Për mëmëdhenë



Blokflaut 1

Blokflaut 2

Blokflaut 3

The musical score is written for three block flutes (Blokflaut 1, 2, and 3) in 3/4 time, key of D major. The score consists of three systems of staves. Blokflaut 1 and 2 play the melody, while Blokflaut 3 provides a bass line. The first system has 4 measures, the second system has 4 measures with a repeat sign, and the third system has 4 measures.



26 Njerëzit e agimeve



Dëgjo këngën dhe diskuto

rreth temës "Çfarë dua të bëhem në të ardhmen? Si do t'i shërbej vendit tim sa më mirë?".

- I -

Mir'mëngjes, mir'mëngjes,
dit' e bukur kaltëron,
mali malin, fusha fushën,
zemra zemrën zgjon.

Si lumenj nëpër rrug',
brigjet, jeta rreh tani,
zërin tënd, hapin tim
i rrëmben në gji.

Brezat varg ëndërruan
një zgjim ja si ky,
me diellin në zemër,
me drit' në sy.

Mes agimesh të zjarrita
hedh shtat brezi im,
si grurin sot mbjell
ditët që vijn'.

- Refreni -

Gëzimi i jetës përflaket
si vezullim në çdo skaj,
ne jemi fladi i ditës së re,
jemi agimi i saj.

- II -

Mir'mëngjes, mir'mëngjes,
zëri zërit i uron
dit' e re, jet' e re
vrull të ri kërkon.

- Refreni -

Në çdo hap çel një këng',
këngë dhe një dashuri,
drejt stacionesh, drejt uzinash
ecim un' e ti.



Njerëzit e agimeve

Muzika: Kujtim Laro
Teksti: Xhevahir Spahiu

Allegro



Mir - mën - gjes, Si lu - menj në - për rrug' dit' e bu - kur kal - të - ron bri - gjet je - ta rreh ta - ni

ma - li, ma - lin fu - sha, fu - shën zem - ra, zem - rën zgjon. gji.
ha - pin tënd zë - rin tim i rrëm - ben në

Bre - zat varg ën - dë - ru - an një zgjim ja si ky

me die - llin në ze - mër me drit' në sy

mes a - gi - mesh të zjarr - ta hedhshtat bre - zi im

si gru - rin sot mbjell di - tët që vijn'

Gë - zi - mi je - tës për - fla - ket si ve - zu - llim nëçdo skaj,

ne je - mi flla - di i di - tës së re je - mi a - gi - mi i saj D.C.



Portofoli yt

- Teksti i këngës më pëlqen, sepse _____
- Melodia e këngës më pëlqen, sepse _____



27 Muzika moderne, rryma dhe përfaqësues



Dëgjo dhe diskuto

këngët "Jailhouse Rock" dhe "No more" të kënduara nga Elvis Presli dhe bëj krahasimin mes tyre, duke veçuar ndryshimet për sa i përket ritmit dhe melodisë.



Muzika **rok** (rock) nisi të zhvillohej si rrymë muzikore në vitet '50, në SHBA. Rrënjët e saj i gjejmë në muzikën rokenroll (rock 'n roll), një lloj muzikor ky i ndikuar nga bluzi (blues), xhazi (jazz) dhe muzika kauntri (country). Ka debate të shumta rreth këngës që duhet të konsiderohet si kënga e parë rokenroll, por ajo që dihet me siguri është se kënga e parë e kësaj gjinie, "Rock around the clock" e Bill Halejit (Bill Haley), arriti të renditej në listat e muzikës më të shitur dhe të ndikonte shumë në popullarizimin e kësaj rryme.

Termi "rokenroll" lindi për të përshkruar tekstet provokuese, ritmet e shpejta dhe rrahjet e forta. Nuk ka një përkufizim që të përcaktojë qartë ndarjen midis muzikës rokenroll dhe asaj rok.

Artistë që kanë kënduar, luajtur dhe kompozuar muzikën rokenroll janë: Elvis Presli (Elvis Presley), Big Xho Turner (Big Joe Turner), Xheri Li Ljuis (Jerry Lee Lewis) etj. Karakteristikë e këtij lloji muzikor ishin kitara elektrike dhe mënyra e regjistrimit të muzikës, që u bënë bazë për zhvillimin e saj të mëtejshëm. **Elvis Presli** ishte një nga artistët e parë që e popullarizoi këtë zhanër. Fama e tij ndërkombëtare arriti në nivele marramendëse, aq sa u mbiquajt "mbret i rokenrollit".

Pothuajse në të njëjtën periudhë me Preslin, u shfaq në skenën ndërkombëtare të muzikës edhe grupi muzikor **The Beatles**, që u formua në vitin 1960 në Liverpul të Anglisë, nga katër djem të rinj:

Xhon Lenon (John Lennon), Pol Makartni (Paul McCartney), Xhorxh Harrison (George Harrison) dhe Ringo Star (Ringo Starr). Ky grup vijoi shndërrimin e muzikës rok në një muzikë gjithmonë e më popullore dhe vazhdon të jetë një nga grupet më të njohura të të gjitha kohërave. Disa nga këngët e tyre më të suksesshme janë: "Can't Buy Me Love", "Twist and Shout", "She Loves You", "I Want to Hold Your Hand", "Please Please Me", "Yesterday" etj.


Muzika rokenroll që më shumë se një stil muzikor, pasi pati efekte sociale në stilin e jetës, të modës, të të menduarit dhe të sjelljes.



Elvis Presli



The Beatles



Fragment nga melodia e këngës "Jailhouse rock", kënduar nga Elvis Presli

Ndikimi i saj filloi të zbutej kur në tregun ndërkombëtar të muzikës u shfaqën rryma të reja me ritëm më të lehtë, sikurse ishte muzika pop.

Muzika pop si rrymë filloi të merrte formën e saj moderne në SHBA dhe Angli, gjatë mesit të viteve '50. Vetë termi i saj është shkurtim i fjalës “popullore”. Kjo muzikë, tashmë vërtet shumë popullore dhe e dashur për publikun, është quajtur ndryshe edhe muzika e trupit. Deri në fund të viteve '60, popi dhe roku ishin terma të përafërt. Artistë që kanë kënduar, luajtur dhe kompozuar muzikën pop janë të shumtë. Ndër ta, midis shumë emrash, përmendim Madonën (Madonna), Uitni Hjustonin (Whitney Houston), Elton Xhonin (Elton John), Majkëll Xheksonin (Michael Jackson), i cili njihet edhe si mbreti i muzikës pop etj.



Grupi “Metallica”

Hard-roku është një nënloj i muzikës rok që filloi rreth viteve '60. Kjo muzikë karakterizohet nga të kënduarit në mënyrë agresive dhe shoqërimi me kitarë bas dhe bateri, shpesh edhe tastierë. Hard roku mori zhvillim të madh në vitet '70, ku u shquan mjaft grupe, si: AC/DC, Led Zeppelin, Deep Purple, Aerosmith etj. Në mesin e viteve '80, ky zhanër arriti kulmin me grupe dhe këngëtarë si: Metallica, Bon Jovi, Def Leppard, Guns N' Roses etj.



“Jaihouse Rock” ➡



Provo aftësitë muzikore

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme.

- ▶ Muzika rokenroll e ka prejardhjen nga _____.
- ▶ Muzika rok e ka prejardhjen nga _____.
- ▶ Hard-roku është nënloj i _____.

2. Rendit disa karakteristika të muzikës rok.



Portofoli yt

- **Kërko** të dhëna mbi muzikën rok and roll dhe nënlojeve të saj.
- **Rendit** një grup muzikor apo këngëtar për secilën rrymë muzikore.
- **Diskuto** një këngëtar apo grup muzikor që të pëlqen më shumë.



28 The final countdown



Dëgjo këngën dhe diskuto

rreth tekstit dhe melodisë së këngës.

- I -

We're leaving together,
But still it's farewell.
And maybe we'll come back
To earth, who can tell?
I guess there is no one to blame
We're leaving ground (leaving ground)
Will things ever be the same again?

- Refreni -

It's the final countdown.
The final countdown

Oh!

We're heading for Venus (Venus)
And still we stand tall
'Cause maybe they've seen us (seen us)
And welcome us all, yeah.
With so many light years to go
And things to be found (to be found)
I'm sure that we'll all miss her so.

- Refreni -

It's the final countdown...
The final countdown [2x]

The final countdown
Oh!

- Refreni -

It's the final countdown
The final countdown [2x]

It's the final countdown
We're leaving together
The final countdown
We'll all miss her so.
It's the final countdown.

- Refreni -

Oh!
It's the final countdown.



Nga koncerti i grupit Evropë në Wacken, Gjermani (2015)

The final countdown

Allegro

Teksti: Joey Tempest

Muzika: Grupi Europe



We're leav - ing to - ge - ther
We're head - ing for Ve - nus

But still it's_ fare - well
And still we_ stand tall



And may - be_ we'll come back
Cause may - be_ they've seen us

To earth who can tell.
And wel - come us all.



I guess there is no one to blame
With so ma - ny light years to go

We're leav - ing the ground_
And things to be found_



Will things ev - er be the same a - gain?_
I'm sure that we all miss her so_

It's the fi - nal count - down.
It's the fi - nal count - down.


A e dini se...

Europe është një grup rok nga Suedia që e filloi veprimtarinë e tij në vitet '80. Albumi i tyre i tretë, "The Final Countdown", pati shumë sukses dhe shënoi kulmin e karrierës së tyre. Grupi përbëhej nga *Joey Tempest, John Norum, John Levén, Mic Michaeli, Ian Haugland*.



Portofoli yt

- **Kërko** të dhëna nga media, gazeta, filma artistikë apo burime të tjera informacioni në lidhje me grupe muzikore dhe këngëtarë që kanë performuar në zhanrin e rok and rollit.
- **Veço** dy karakteristika të këtij zhanri muzikor dhe dy karakteristika të performimit të këngëtarëve apo grupeve muzikore.
- **Gjej** fakte e fotografi nga koncertet që ata kanë zhvilluar.
- **Krijo** një playlist apo CD me vepra muzikore të zgjedhura nga performimi i këngëtarit apo grupit muzikor më të pëlqyer.



Verifiko njohuritë

1

Rretho përgjigjen e saktë.

- Si quhet lëvizja kulturore e artistike që u zhvillua në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX në Evropë?
a. Impresionizëm; **b.** Iluminizëm; **c.** Verizëm.

2

Rretho në pohimet e mëposhtme **V** (e vërtetë) ose **G** (e gabuar).

- Në Impresionizëm, kompozitori vë në qendër të vëmendjes tingullin dhe atmosferën që krijon muzika dhe jo formën e saj. **V G**
- Verizmi është një rrymë pasromantike, e cila fillimisht lindi si lëvizje muzikore. **V G**
- Verizmi u përhap në Itali, Francë dhe Poloni. **V G**
- Në Francë, Impresionizmi muzikor u përfaqësua nga kompozitori Klod Debysi. **V G**

3

Plotëso fjalitë e mëposhtme.


- Përfaqësuesit e muzikës rok and roll janë: _____.
- Muzika rokenroll lindi në vitet _____ në Amerikë dhe Angli.
- Muzika rokenroll e ka prejardhjen e saj nga _____.

4

Shkruaj tri fakte rreth jetës dhe veprimtarisë së grupit *The Beatles*.

5

Lidh me shigjetë emrin e kompozitorit me veprën muzikore.



Pjetër Maskanji

“Karmen”

Xhakomo Puçini

“Kavaleria rustikana”

Ruxhero Leonkavallo

“Paliaço”

Zhorzh Bize

“Rapsodia blu”

Dimitri Shostakoviç

“Bohema”

Xhorxh Gershuin

“Vals Nr. 2. Op. 99”

6

Përshkruaj me disa fjali këngëtarin/en tënd/e të parapëlqyer.

a) Muzika që ai/ajo këndon: _____

b) Stili i paraqitjes së tij/saj: _____

c) Mesazhi që përcjell me këngët e tij/saj: _____



Jeta dhe vepra e një kompozitori

Për realizimin e projektit, duhet:

1. të punohet vetëm dhe në grup;
2. të kërkohet informacion nga burime të ndryshme (libra, internet);
3. të përdoren teknologji të ndryshme për marrjen e të dhënave dhe organizimin e tyre;
4. të paraqiten punimet në mënyrë të kuptueshme për të gjithë;
5. të krijohen prezantime në PowerPoint; CD, DVD.

Hapat për realizimin e projektit

Kërkime mbi jetëshkrimin e kompozitorit:

- Informacion për periudhën në të cilën kompozitori zhvilloi veprimtarinë e tij, duke përfshirë këtu edhe të dhëna rreth jetës, fotografi, fakte domethënëse, kuriozitete etj.



Kërkime mbi krijimin e veprave muzikore:

Informacion për:

1. karakteristikat e periudhës në të cilën jetoi dhe punoi kompozitori;
2. veprat e tij muzikore;
3. stilin muzikor të veprave të tij;
4. llojet dhe gjinitë muzikore në të cilat krijoi;
5. fakte, dokumentime dhe kompozime muzikore (incizime).



Paraqitja dhe diskutimi i materialeve të gjetura:

- përzgjedhje e informacioneve të gjetura, duke veçuar materialet më të spikatura.

Rezultatet e arritura



1. Material informues mbi jetën e kompozitorit të zgjedhur: dokumente, fakte biografike, ngjarje personale.
2. Material informues mbi periudhën kur e zhvilloi veprimtarinë krijuese kompozitori.
3. Material shpjegues mbi:
 - stilin muzikor të kompozitorit;
 - stilet muzikore që u zhvilluan gjatë periudhës që ai krijoi;
 - gjininë/të që lëvroi;
 - risitë që përcolli përmes veprave të tij.
4. Vepra muzikore të incizuara në audio apo video.
5. Prezantim shpjegues me temë “Jeta dhe vepra e një kompozitori”.
6. CD apo DVD me vepra nga krijimtaria e kompozitorit.





Grupi 403 gjatë një koncerti

Njësia mësimore 29: Këngë moj

Njësia mësimore 30: Krijim muzikor

Njësia mësimore 31: Mall për mëmëdhenë

Njësia mësimore 32: Interpretues shqiptarë dhe kosovarë

Njësia mësimore 33: Mjete teknike për dëgjim dhe incizim

Njësia mësimore 34: Njohim kitarën

Njësia mësimore 35: Luajmë në instrument

Njësia mësimore 36: Profesionet muzikore

Verifiko njohuritë

Projekt 3: Grupi ose këngëtari im i preferuar



Aftësitë e nxënësit/es:

- **këndon** këngët në ritmet dhe tonalitetet e mësuara;
- **krijon** në ritmet e mësuara, duke përdorur simbolet muzikore përkatëse;
- **plotëson** më tej njohuritë mbi zhvillimin e muzikës moderne në Kosovë, përfaqësuesit, veprat dhe krijimet përmes ngjarjeve kulturore;
- **dëgjon** muzikë dhe përjeton emocionet që përcjell ajo;
- **zbulon** ndjesitë që krijon muzika dhe i përshkruan ato;
- **reflekton** ndaj muzikës që dëgjon, si pjesë e kohës në të cilën u krijua;
- **përdor** njohuritë për të krijuar ese, tema projektesh të ndryshme etj., individualisht ose në grup.



Fjalë kyçe:

muzika moderne kosovare, mjete teknike



Dëgjo këngën dhe diskuto

duke ngjyrosur të gjitha figurat letrare që ka përdorur poeti.
Analizojini ato me njëri-tjetrin.

- I -

Këngë moj ti merre dhenë,
Kush ta ngriti ty moj folenë,
Mos më rri ti e nguuar,
Shëroji shpirtrat e helmuar,
Hej, hej, hej, hej, hej, hej!

- Refreni -

Këngë moj buçit në male,
Dhe barinjt' le të hedhin valle,
Edhe qingjat le t'blegrojnë,
Kur bilbilat të këndojn' o hej!

- II -

Këngë moj ti thua lart,
Mallëngjim djalli ta marrtë,
Këngë moj na mbush me gëzime,
Se n'ty shpirti gjen ngushëllime,
Hej, hej, hej, hej, hej, hej!

- Refreni -

Këngë moj buçit në male,
Dhe barinjt' le të hedhin valle,
Edhe qingjat le t'blegrojnë,
Kur bilbilat të këndojn' o hej!



Pamje nga Thethi, Shqipëri

Këngë moj

Muzika: Musa Piperku

Teksti: Nehat S. Hoxha



Kën - gë moj ti me - rre dhe - në, kush ta ngri - ti

ty moj fo - le - në Mos më rri ti e ngu - ju - ar

shë - roji shpir - trat e hel - mu - ar, Hej, hej,

hej, hej, hej, hej hej _____, hej _____.

Kën - gë moj bu - çit në ma - le dhe ba - rinjt' le

t'he - dhin va - lle E - dhe qi - ngjat le t'bleg - roj - në,

kur bil - bi - lat të kën - dojn' o hej _____.

1. hej _____.

2. hej _____.



Portofoli yt

- Teksti i këngës më pëlqen, sepse _____
- _____.
- Melodia e këngës më pëlqen, sepse _____
- _____.



30 Krijojmë së bashku

Koncerti “Pranvera” është një nga katër kohët e veprës muzikore “Katër stinët” e A. Vivaldit. Koha e parë “Pranvera” e Vivaldit është Allegro, që do të thotë se muzika luhet shpejt. Nisur nga kjo, për realizimin e punimit tënd sugjerojmë të përdoren ngjyrat e ngrohta apo të gjalla, si dhe të kombinohen ato me elementet e tjera si forma, vija, kontrasti etj.



Kuarteti Katër Stinët

Karakterit muzikor dhe ngjyrat janë zërat e brendshëm të gjendjes shpirtërore që mund t'i provosh duke dëgjuar një pjesë muzikore. Këto dy elemente (të muzikës dhe të artit figurativ) do të bëjnë pjesë në ndjenjat dhe në krijimin tënd.



Dëgjo koncertin “Pranvera” nga “Katër stinët” e Antonio Vivaldit, dhe përcill emocionet e tua përmes artit figurativ, duke përdorur elementet e artit.

Hapat për të zhvilluar krijimin tënd.

- **Dëgjo** koncertin “Pranvera” nga “Katër stinët”.
- **Përcakto** karakterin dhe shpejtësinë e melodisë: allegro, moderato ose adagio.
- **Vazhdo** të dëgjosh veprën muzikore dhe fillo të skicosh punimin tënd nëpërmjet emocioneve që të jep muzika.
- Pasi të skicosh idenë, **fillo** ngjyrosjen e punimit me ngjyrat që ke zgjedhur.



Wassily Kandinsky, Improvizim nr. 26 (vaj në kanavacë, ArtsDot)

Plotëso pas dëgjimit dhe krijimit:

- Koncerti: “Pranvera”
- Kompozitori: Antonio Vivaldi
- Shpejtësia në të cilën ekzekutohet pjesa: _____
- Karakteri i pjesës: _____
- Ngjyrat që unë përdora në punimin tim: _____
- Instrumenti që luhet vepra muzikore: _____



Dëgjo fragmentin muzikor shkëputur nga vepra: "Fluturimi i brumbullit", Rimski-Korsakov. Ndiq hapat e mësipërm për realizimin e tablosë sate.

Plotëso pas dëgjimit dhe krijimit:

- Vepra muzikore: *"Fluturimi i brumbullit"*
- Kompozitori: Rimski-Korsakov
- Shpejtësia në të cilën ekzekutohet pjesa: _____
- Karakteri i pjesës: _____
- Ngjyrat që unë përdora në punimin tim: _____
- Instrumenti me të cilin luhet vepra muzikore: _____



31 Mall për mëmëdhenë



Dëgjo këngën dhe diskuto

a të ka rastisur të të marrë malli për qytetin tënd, kur ke qenë larg tij?

- I -

Në breg pul'bardhat çajnë fluturim
si kënga jon' plot mall,
këndojm' nga larg
me dashuri, moj Arbëri.

Të parët tanë me breng' të lan'
sa kohë më nuk të pan',
por sot si lule më je ti,
moj Shqipëri.

- Refreni -

Valët e detit shkumbojn' plot dallg',
bashkë me shokët në breg kemi dal',
sa kemi mall s'ka deti val',
o moj e bukur Arbëri.


Shikojm' nga larg,
mendojm' për ty,
o moj e bukur Shqipëri.
Këtej ne degët, ti rrënjë matan,
mes detit në stuhi,
shkuan kaq mote e degët s'u than',
moj Arbëri.

Kjo kënga jonë për ty përher',
na djeg si zjarr në gji,
te zjarri yt ne jemi përjet',
moj Shqipëri.

- Refreni -

Valët e detit shkumbojn' plot dallg',
bashkë me shokët në breg kemi dal',
sa kemi mall s'ka deti val',
o moj e bukur Arbëri.

Shikojm' nga larg mendojm' për ty
o moj e bukur Shqipëri,
shikojm' nga larg mendojmë për ty,
o moj e bukur Shqipëri!



Mall për mëmëdhenë

Allegretto

Teksti: Hysni Millosi

Muzika: Avni Mula



Në breg pul' - bar - dhat çajn' flu - tu - rim si kën - ga jon' plot mall,



kën - dojm' nga larg me da - shu - ri, moj Ar - bë - ri_____.



Të pa - rët ta - në në breg të lan' sa koh' më nuk të pan',



por sot si lu - le më je ti, moj Shqi - pë - ri_____.



Va - lët e de - tit shkrum - bojn çdo dallg' bash - kë me sho - kët në breg ke - mi dal'



Sa ke - mi mall s'ka de - ti val', o moj e bu - kur Ar - bë - ri



Shi - kojm' nga larg men - dojm' ty, moj e bu - kur Shqi - pë - ri_____.



32 Interpretues shqiptarë

Ermonela Jaho lindi më 1974 në Tiranë dhe po aty kreu studimet për kanto në liceun artistik “Jordan Misja”. Pasi fitoi konkursin e organizuar nga sopranoja italiane Katia Riçareli, shkoi në Itali, ku studioi kanto në akademinë “Santa Cecilia” në Romë. Jaho është një nga këngëtalet lirike shqiptare më të famshme. Ajo ka interpretuar në skenat e mëdha botërore (Londër, Nju-Jork, Filadelfia, Mantova, Verona, Milano etj.) vepra operistike të rëndësishme, si: “Hirushja” e Rosinit, “Miku Fric” e Maskanjit, “Traviata” e Verdit, “Madamë Batërfaj” e Puçinit, “Bohema” e Puçinit etj.



Ermonela Jaho



Rame Lahaj

Rame Lahaj është tenor i operës së Kosovës i njohur për performancat në shtëpitë më të njohura të operës në botë. Ndër rolet e tij të shquara janë Alfredo tek opera “La Traviata”, roli i Dukës së Mantovës tek opera “Rigoletto”, roli i Rodolfos tek opera “La Bohème”, roli i Edgardos tek opera “Lucia di Lammermor” dhe roli i Pinkertonit tek opera “Madama Butterfly”. Rame Lahaj ka lindur në Istog të Kosovës më 1983. Ai është artisti i parë, para dhe pas luftës, që performoi në skenat më të rëndësishme ndërkombëtare të operës, përkrah emrave të mëdhenj si Plaçido Domingo, performanca të cilat i dhanë edhe çmimin e madh në Konkursit Botëror të Operës, çmimin prestigjioz dhe të rëndësishëm

“Operalia” në vitin 2016. Gjatë dekadës së tij të parë në këtë profesion, Lahaj u shfaq në skena nga më prestigjiozet, përfshi Shtëpinë e Operës Mbretërore Covent Garden në Londër, Operën Kombëtare të Parisit, Teatrin Bolshoi në Moskë, Gran Teatre del Liceu në Barcelonë, Arenën e Veronës, Operën e Australisë në Sidnei, Los Angeles Opera, Teatro Real në Madrid, Deutsche Oper në Berlin, Staatsoper në Berlin, Haus Für Mozart në Salzburg, Semperoper në Dresden, Royal Albert Hall në Londër, Operën e Tel Avivit, Teatro Massimo në Palermo dhe shumë të tjerë.

Josif Gjipali është këngëtar i njohur, lindur në Vlorë. Pas diplomimit në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, Josif Gjipali e nisi karrierën (1999) si solist në Teatrin e Operës dhe Baletit. Më 2002 fitoi çmimin e parë në "Tito Gobbi", një konkurs mbi muzikën operistike. Një vit më vonë fitoi çmimin e dytë në "Operalian" e Plácido Domingos, një konkurs me emër në botën operistike për këngëtarët e rinj. Ky konkurs i dha mundësinë që të njëjët nga emrat e njohur të kësaj bote, nga ku nisi dhe karriera e tij ndërkombëtare. Ka një karrierë të mrekullueshme në skenat e Evropës, dhe ka luajtur role nga më të rëndësishmet si tenor në operat e mëdha, duke fituar emrin e veçantë të një tenori të klasit të parë. Mbas një karriere të suksesshme në Shqipëri, ai ka debutuar në skenën e La Scala-s (Milano), si dhe në shumë skena nga më prestigjiozet e Evropës, në rolet e operave si "Trovatore", "Traviata", "Ballo me maska", "Bohema", "Turandot", "Toska", "Norma" etj. Vlerësohet si një prej zërave më të mirë lirikë.



Josif Gjipali



Elbenita Kajtazi

Elbenita Kajtazi është një soprano e cila i ka kryer studimet në Shkollën e Mesme të Muzikës në Mitrovicë dhe më pas studimet në Universitetin e Prishtinës. Debutimin e saj e pati me Orkestrën Filarmonike të Kosovës në vitin 2009, duke kënduar në shumë koncerte gjatë gjithë sezonit. Elbenita Kajtazi ka fituar disa çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Më së fundi, ajo fitoi çmimin e parë në "International Competition Riccardo Zandonai", në 2015, në Itali, së bashku me dy çmime të veçanta. Në vitin 2014, fitoi çmimin e parë "Spiros Argiris" në Festivalin Sarzana, Itali. Në vitin 2012, ajo fitoi çmimin e parë në Festivalin e Këngës së Flamurit dhe Koncertin Ndërkombëtar të Muzikës ARS Kosova 2009. Gjithashtu mori një bursë në verën e vitit 2013 për të ndjekur Programin Campo d'Oro në Nju-Jork.



Portofoli yt

- **Veço** interpretuesin/en tënd/e të parapëlqyer dhe shkruaj më gjerë rreth veprimtarisë së tij muzikore, duke u ndalur në një prej veprave të tij/saj.



33 Mjetet teknike për regjistrim e dëgjim muzikor

Pjesët muzikore që dëgjoni në shtëpi ose në çdo mjedis ku ka muzikë, në përgjithësi, janë regjistrime në disk ose CD. Por si bëhet regjistrimi i zërave ose i një muzike?

Regjistrimi bëhet në një sallë ose dhomë regjistrimi që është e izoluar mirë nga zhurmat. Aty ndodhet interpretuesja ose interpretuesi, si dhe mjetet fonike. Kjo sallë/dhomë komunikon nëpërmjet një xhami me një tjetër sallë/dhomë, ku gjenden të sistemuara të gjitha aparaturat për regjistrim. Impulset zanore transformohen në impulse elektrike nga mikrofoni, nëpërmjet disa fijeve që arrijnë në këtë sallë, të quajtur **salla e regjistrimit**, ku tekniku i regjistrimit (fonisë) punon me aparatura të veçanta dhe i regjistron mbi një regjistrator të veçantë që quhet **multipistë**.

Miksimi është faza që ndjek regjistrimin deri në momentin kur vjen te **mikseri**, i cili është një aparaturë që bashkon harmonikisht pjesë të veçanta. I gjithë regjistrimi kthehet mbi një regjistrator të dytë të quajtur **master**, ku vijnë të regjistruara vetëm dy pista që korrespondojnë me dy kanale *stereofonike* dhe ku pastaj kalon në *transfer*, një aparaturë që transferon tinguj në **master** mbi një disk-kampion.



Kompakt-disku është aparatura që të lejon dëgjimin e një disku të vogël, me diametër 12 cm, që përmban tingujt e regjistruar.



Magnetofoni është pajisje që shërben për të dëgjuar muzikë, me CS - CD. Magnetofoni përdoret edhe për të riprodhuar muzikë sipas dëshirave tona sepse është mjet shumë praktik. Ai përdoret për të dëgjuar ose ilustruar nga ana didaktike në shkollë, një melodi muzikore, një monolog, dialog në shqip ose gjuhë të huaj etj.



Kasetofoni është mjet që shërben për të dëgjuar muzikë apo biseda të ndryshme, në mënyrë individuale.

Radioja është pajisja elektronike që merr valët radio dhe e konverton informacionin që ato bartin në formë të përdorshme zanore. Ka antenë, e cila kap valët elektromagnetike të frekuencës radio që bartin informacionin në fjalë.



Televizori. Fjala “televizor” do të thotë “pamje nga shumë larg”. Televizori përbëhet nga tri pjesë kryesore: sintetizatori, altoparlanti, tubi me rrezet katodike dhe ekrani i televizorit

Celulari është pajisje që shërben për komunikim dhe për të dëgjuar muzikë.

● Duke përdorur programe dhe aplikacione të ndryshme kompjuterike apo në telefonat tuaj, krijoni muzikë të llojit dhe zhanrit që ju pëlqen. Krijimin prezantoheni në klasë.





34 Luajmë në kitarë

Kitara është instrument me tela, me origjinë shumë të lashtë, e cila bën pjesë në familjen kordofone. Ekzistojnë lloje të ndryshme kitarash, të cilat ndryshojnë nga forma, materiali, timbri, duke u përshtatur gjinisë muzikore. Kitara standarde ka 6 tela, por kemi kitara që kanë 4, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 18 tela.

Dy familjet kryesore të kitarës janë **kitarat akustike** dhe **kitarat elektrike**. Tri llojet kryesore të kitarës akustike janë kitara

klasike (me fije najloni), kitara me tela çeliku dhe kitara *archtop*.

Kitarat janë njohur si një nga instrumentet kryesore në shoqërimin e muzikës *flamengo*, *xhaz*, *bluz*, *kantri*, *mariaçi*, *rok* dhe shumë forma të tjera të popit.



Kitara akustike

Kitara klasike me përbërje druri, përbëhet nga tri pjesë: kasa, doreza, telat. Kasa ka formën e numrit 8, me një vrimë të rrumbullakët që shërben për të amplifikuar tingujt e prodhuar nga telat. Doreza zgjatet mbi kasë e deri tek ura. Tastet janë të ndara nga disa të ngritura vertikale prej metali. Disa taste (3, 5, 7 etj.) janë të shënuara me pika të bardha që shërbejnë për të gjetur tingujt. Ato quhen tregues të pozicioneve. Gjashtë telat (prej najloni ose metali) janë të ndryshme dhe shtrihen të tendosura nga kordiera (mbajtësja e telave) deri te çelësat akordues. Mbi kordierë është ura, që shërben për të mbajtur telat më lart nga kasa harmonike.




Kitara akustike

Kitara elektrike është instrument që kërkon përforsim të jashtëm në mënyrë që të dëgjohet në volumet normale të performancës artistike (ndryshe nga kitara akustike, që s'ka nevojë për rrymë elektrike që të dëgjohet, por vetëm - në rastin e kitarës gjysmë-akustike elektrike - për përforsimin e volumit). Kitara elektrike i kthen dridhjet e fijeve në sinjale elektrike, shpesh të moduluara në tonalitete të ndryshme. Shpesh kjo bëhet nëpërmjet përdorimit të efekteve të tilla elektrike si kumbimi, shtrembërimi apo stërzgjatja. U shpik më 1932 dhe fitoi menjëherë popullaritet, sidomos në rrymat bluz, jaz e më pas rok, për t'u bërë më vonë element bazë i rrymave të tilla si roku e metali.



Kitara elektrike



Me instrumentin e kitarës klasike mund të luhet duke qëndruar ulur, me këmbën e majtë të vendosur mbi një shkallë të ngritur. Instrumenti vendoset mbi kofshën e majtë dhe mbështetet pas trupit, ndërsa krahu i djathtë vendoset lirisht mbi kasë. Dora e djathtë duhet të vendoset në një pozicion të tillë për të pickuar telat mbi “shpirtin tingëllues”.

Dora e majtë qëndron e lirë deri në momentin që do të fillojë të prekë telat e kitarës.

Dora e djathtë

- Duhet të luajë mbi tela, duke i bërë ato të dridhen dhe të prodhojnë tingujt. Telat krijojnë dridhje përmes:
 - *gishtave* (me përjashtim të gishtit të vogël);
 - *plektrumit* (penzës), një gjuhëz e vogël prej materiali plastik, që mbahet ndërmjet gishtit të madh dhe atij tregues në pozicion pingul. Të dy gishtat mund edhe të pickojnë telat e kitarës për të luajtur një melodi, ose për të mbajtur një akord.

Dora e majtë

- *Gishtat* e kësaj dore shërbejnë për të luajtur me telat e kitarës, duke i vendosur mbi tastet e dorezës. Pozicionet që marrin gishtat gjatë luajtjes në kitarë, krijojnë tinguj me gjatësi dhe lartësi të ndryshme.
- *Gishti i madh* vendoset nën dorezën e kitarës dhe shërben për të mbajtur presionin e gishtave të tjerë mbi tastierë.
- Dora duhet të jetë e kthyer, te pulsi, në formë harku, në mënyrë të atillë që mollëzat e gishtave të prekin lehtësisht tastet e kitarës.





35 Luajmë në kitarë

Si të kuptojmë figurën?

	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
1 Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol La b	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi ecc.
2 Si	Do b	Do# Reb	Re	Re Mi b	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si ecc.
3 Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol ecc.
4 Re	Re# Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re ecc.
5 La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La ecc.
6 Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi ecc.

- Numrat **1, 2, 3, 4, 5, 6** që janë në të majtë të figurës, shërbejnë për të treguar **telat e kitarës**.
- Numrat **1, 2, 3, 4** sipër figurës së kitarës, shërbejnë për të treguar **vendosjen e gishtave** mbi dorezën e kitarës.
- *Gishtat e dorës së majtë* (mbi dorezë) kanë numrat:
gishti tregues → **1**
gishti i mesit → **2**
gishti i unazës → **3**
gishti i vogël → **4**

- Gishti i madh nuk ka numër, sepse nuk i prek telat.
- Gishtat e dorës së djathtë, që shërbejnë për të pickuar telat dhe rrinë të mbledhura janë:
gishti i madh;
gishti tregues;
gishti i mesit;
gishti i unazës.
Gishti i vogël nuk përdoret.



Zgjero njohuritë

1. Kërko nga burime të ndryshme të dhëna rreth jetës dhe veprimtarisë së këngëtarit dhe kitaristit Xhimi Hendriks, duke renditur dy fakte rreth tij.



Jimi Hendrix gjatë një koncerti në Royal Albert Hall në Londër, Britani e Madhe (1969)

2. Rendit dy interpretime muzikore nga ky artist.

3. Shkruaj disa fjali, duke shprehur me gjuhë të thjeshtë muzikore përshtypjet e tua mbi emocionet e interpretimeve muzikore të parapëlqyera.



36 Profesionet muzikore

Profesionet janë të ndryshme në çdo fushë të jetës sonë. Në muzikë, profesionet janë: instrumentistë, këngëtarë, kompozitorë, dirigjentë, mësimdhënës të edukatës muzikore, muzikologë, etnomuzikologë, kritikë muzike, historianë. Të gjithë ata/ato shkollohen në institucionet arsimore të përgjithshme dhe më pas përgatiten në një drejtim më të ngushtë për profesionin që duan të zhvillojnë.

Kompozitori/ja duhet të jetë i/e aftë në:

- kompozimin e llojeve të ndryshme muzikore.

Ato mund të jenë:

- muzikë klasike, vokale, baleti ose instrumentale;
- muzikë e lehtë;
- muzikë popullore;
- muzikë për fëmijë.



Lorenc Antoni



Shkëlzen Dolli

Instrumentisti/ja duhet të jetë i/e aftë në:

- ekzekutimin dhe interpretimin e veprave muzikore në instrument solo ose në ansambël/orkestër.

Instrumentistët janë:

- pianistë, violinistë, flautistë, kitaristë, klarinetistë, fizarmonicistë etj.

Këngëtari/ja duhet të jetë i/e aftë në:

- interpretimin e veprave muzikore solo ose në kor.



Nexhmije Pagarusha

Dirigjenti/ja duhet të jetë i/e aftë në drejtimin:

- ▶ e një orkestre simfonike;
- ▶ e një kori për të rritur, për të rinj, për fëmijë, *a cappella*;
- ▶ e një ansambli instrumental;
- ▶ e një bande etj.



Bahri Çela



Mësimdhënës muzike

Mësimdhënësi/ja duhet të jetë i/e aftë në edukimin e brezit të ri, në mënyrë që ata të zotërojnë:

- ▶ instrumente të ndryshme muzikore;
- ▶ këndimin;
- ▶ lëndët teorike dhe praktike muzikore etj.

Muzikologu/ja duhet të jetë i/e aftë në:

- ▶ dokumentimin e historisë së muzikës, veprave muzikore dhe përfaqësuesve të saj.




Engjëll Berisha



Rexhep Munishi

Etnomuzikologu/ja duhet të jetë i/e aftë në:

- ▶ dokumentimin e folklorit muzikor.



Verifiko njohuritë

1

Rendit disa interpretues shqiptarë dhe kosovarë:

2

Cilat janë disa nga aftësitë e profesioneve muzikore:

- Aftësitë që zotëron **kompozitori/ja** janë:

- Aftësitë që zotëron **instrumentisti/ja** janë:

- Aftësitë që zotëron **këngëtari/ja** janë:

- Aftësitë që zotëron **dirigjenti/ja** janë:

- Aftësitë që zotëron **mësimdhënësi/ja** janë:

- Aftësitë që zotëron **muzikologu/ja** janë:

- Aftësitë që zotëron **etnomuzikologu/ja** janë:

3

Lidh me shigjetë fotografinë me emrin e këngëtarit.



Shpat Deda



Rona Nishliu



Genc Salihu



Aurela Gaçe



Dua Lipa

4

Shkruaj rreth krijimtarisë së muzikës së lehtë kosovare.

Grupi ose këngëtari im i parapëlqyer

Për realizimin e projektit, duhet:

1. të punohet vetëm dhe në grup;
2. të kërkohet informacion nga burime të ndryshme (libra, internet);
3. të përdoren teknologji të ndryshme për marrjen e të dhënave dhe organizimin e tyre;
4. të paraqiten punimet në mënyrë të kuptueshme për të gjithë;
5. të krijohen prezantime në *PowerPoint*; CD, DVD.

Hapat për realizimin e projektit

Ndarja e grupeve sipas interesave dhe njohurive



● Hapi I: Kërkim informacioni mbi historinë e zhvillimit të muzikës moderne

- Informacion mbi historikun dhe zhvillimin e muzikës moderne: xhaz, bluz, rok, pop etj.
- Të dhëna të ndryshme, si: fakte, fotografi, ngjarje, kuriozitete mbi zhvillimin e muzikës moderne dhe të rrymave të ndryshme muzikore.

● Hapi II: Kërkim informacioni për grupin ose këngëtarin e parapëlqyer

- Të dhëna rreth jetës dhe veprimtarisë së tij (fotografi, fakte domethënëse, kuriozitete apo ngjarje personale nga jeta, nga koncerte të ndryshme etj.).



● Hapi III: Përpunimi i informacionit

- Sistemon informacionin e grumbulluar, e përzgjedh dhe e përgatit atë për prezantim.

Rezultatet e arritura



Rezultatet e hapit I:

- Material informues mbi zhvillimin e muzikës xhaz, bluz, rok, pop etj.

Rezultatet e hapit II:

- Material informues mbi jetën dhe veprimtarinë e grupit ose këngëtarit të parapëlqyer të muzikës xhaz, bluz, rok, pop etj.: dokumente, fakte biografike, ngjarje personale etj.



Rezultatet e hapit III:

- Prezantim shpjegues me temë “Këngëtari/ja ose grupi im i parapëlqyer”.
- CD ose DVD me këngë të zgjedhura.



baladë - formë muzikore më e thjeshtë nga përmbajtja, që këndohet nga një solist, me kor ose shoqërim instrumental.

balet - valle ose shfaqje skenike, ku veprimi dramatik kryhet përmes lëvizjes, vallëzimit dhe pantomimës nën shoqërimin e muzikës.

barok - periudha artistike rreth viteve 1600-1750, e cila solli krijimin e një muzike më të stërholluar dhe me ornamente.

dirigjenti/ja - personi që drejton një orkestër simfonike, kori për të rritur, për të rinj, për fëmijë, a cappella, ansambël, instrumental, bandë etj.

Ekspresionizëm - drejtim artistik që lindi së pari në pikturë dhe më pas në muzikë e arte të tjera.

Iluminizëm - lëvizje ideo-artistike në Evropë që tregonte gjendjen shpirtërore, zhgënjimin dhe pakënaqësinë ndaj realitetit ekzistues, e cila shprehej në forma dhe mënyra të larmishme.

instrumentisti/ja - personi që ekzekuton në instrument solo ose në ansambël/orkestër.

kaça - formë muzikore me dy zëra, këngë e shpejtë, teksti i së cilës trajton një skenë gjahu.

kasetofon - mjet që shërben për të dëgjuar muzikë apo biseda.

këngë gregoriane - këngë për kore burrash dhe që këndoheshin njëzëri nga i gjithë kori.

këngëtari/ja - personi që interpreton solo ose në kor.

kitarë - instrument me tela.

Klasicizëm - periudha artistike rreth viteve 1600-1750.

kompakt-disk - aparatura që të lejon dëgjimin e një disku të vogël.

kompozitori/ja - personi që kompozon lloje të ndryshme muzikore.

koncert - kompozim muzikor për një ose një tërësi instrumentesh.

korno - instrument frymor.

liut - lloj violine.

madrigal - formë muzikore polifonike me dy ose tre zëra, që zakonisht përbëhet nga dy strofa dhe një refren, me subjekt mitologjik ose humoristik.

magnetofon - pajisje që shërben për të dëgjuar muzikë.

melodramë - formë spektakli ku rrëfëhet një histori me anë të muzikës dhe të të kënduarit.

Mesjetë - ajo periudhë e historisë evropiane që fillon nga rënia e perandorisë romake (476 e.r.) dhe përfundon me zbulimin e Amerikës (1492).

miksim - faza që ndjek regjistrimin deri në momentin kur vjen te mikseri.

monofoni - formë kompozimi në një zë.

muzikë me program - vepër muzikore instrumentale që mbështetet ose pasqyron një përmbajtje të caktuar.

muzikologu/ja - personi që dokumenton historinë e muzikës, veprat muzikore dhe përfaqësuesve të saj.

neumat - simbole muzikore që përdoren vetëm në krijimin e melodive me një zë.

opera bufa (gazmore) - vepër muzikore komike, ku karakteret merren nga jeta e përditshme.

opera seria (serioze) - opera tipike e periudhës së klasicizmit, e cila gjeti zhvillim të rëndësishëm, sidomos në strukturë dhe gjuhë muzikore.

oratorio - formë muzikore dramatike, me tekst në gjuhën latine, e ngjashme me operën, e cila dëgjohet kryesisht në kishë.

organum - forma e parë polifonike.

polifoni - formë kompozimi në shumë tinguj.

radio - pajisja elektronike që merr valët radio dhe e konverton informacionin që ato bartin në formë të përdorshme zanore.

regjistrim - sallë ose dhomë regjistrimi që është e izoluar mirë nga zhurmat.

Rilindje - lëvizje e madhe kulturore e shekullit XV-XVI, e cila u dha jetë idealeve humaniste të qytetërimeve antike romake dhe greke.

Romantizëm - lëvizje ideo-artistike gjatë shekullit XIX, e cila përfshiu letërsinë, teatrin, pikturën dhe muzikën.

sonatë - kompozim instrumental në disa kohë.

televizor - aparaturë që përbëhet nga tri pjesë kryesore: sintetizatori, altoparlanti, tubi me rrezet katodike dhe ekrani i televizorit.

tetragram - shenjat ndërmjet katër vijave paralele horizontale.

tonalitet muzikor - karakteri i një pjese muzikale që përcaktohet nga shkalla muzikore mbi të cilën ekzekutohet.

trombë - instrument frymor.

Verizëm - drejtim artistik postromantik, i cili fillimisht lindi si lëvizje letrare.

viele - instrument me hark.

REFERENCA

- E. Koço: *Kënga lirike qytetare shqiptare në vitet 1930*, Tiranë, 2002
- G. Neubacher, *Blockflotenbuch 1*
- K. N. Mullai, *Edukata muzikore V, VI*, Tiranë, 1998
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, gusht, 2016
- Kurrikulat lëndore/programi mësimor *Art muzikor 9*, Kosovë, gusht, 2019
- N. Doko, Sh. Mara, *Solfezhi për klasat e muzikës të shkollës 8-vjeçare*, Tiranë, 1982
- P. Miso, *Veglat muzikore kordofone*, Tiranë, Shqipëri, 2008
- R. P. Castello, *Fantasia e Musica (A-B-C)*, 2011
- R. Radoja, A. Hoxha, *Këngët e Atdheut*, Tiranë, 2015
- R. Sokoli, *Folklori muzikor shqiptar*, Tiranë, 1965
- R. Sokoli, P. Miso, *Veglat muzikore të popullit shqiptar*, Tiranë, 1991
- S. Kalemi, *Historia e muzikës*, pjesa 1, Tiranë, 1973
- T. Zadeja, S. Kalemi, *Metodika e mësimi të këngës dhe muzikës*, Tiranë, 1988
- V. S. Tole, *Folklori muzikor (monodia shqiptare, polifonia shqiptare)*, Tiranë, 1999, 200
- <https://www.dreamstime.com/>

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:78(075.2)

Hala, Majlinda

Art muzikor 9 : për klasën e 9-të të arsimit 9-vjeçar / Majlinda
Hala ...[etj.]. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 107 f. : ilustr. ; 28 cm

1. Shamku, Violeta 2. Kryeziu, Rreze 3. Jupolli, Liburn

ISBN 978-9951-843-37-9